



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 28 MAJ 2015**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 28. MAJA 2015. GODINE**

**MAJ - MAJ
2015**

Rendi i ditës

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Avokatin e Popullit,
2. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit kundër diskriminimit,
3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për barazi gjinore.
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për gjykatat,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurorin e Shtetit,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për përgjimin e telekomunikimeve,
9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për kompensimin e viktimave të krimit,
10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar.

Dnevni red

1. Drugo razmatranje Nacrt zakona o Narodnom advokatu,
2. Drugo razmatranje Nacrt zakona protiv diskriminacije,
3. Drugo razmatranje Nacrt zakona o polnoj ravnopravnosti, .
4. Drugo razmatranje Nacrt zakona o izmeni i dopuni Zakona o sudovima,
5. Drugo razmatranje Nacrt zakona o izmeni i dopuni Zakona o Sudskom savetu Kosova,
6. Drugo razmatranje Nacrt zakona o izmeni i dopuni Zakona o Tužilačkom savetu Kosova,
7. Drugo razmatranje Nacrt zakona o izmeni i dopuni Zakona o državnom tužiocu,
8. Drugo razmatranje Nacrt zakona o prisluškivanju telekomunikacija,
9. Drugo razmatranje Nacrt zakona o naknadi žrtava zločina,
10. Drugo razmatranje Nacrt zakona porezu na dodatnu vrednost.

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Ju kisha lutur, 20 minuta jemi duke pritur. Po e shohim se kanë ardhur mbi 61 deputetë, por uluni në sallë për arsye nga hyrje-daljet po humb edhe numri i deputetëve. Na nevojitet që për të proceduar në leximin e dytë t'i kemi 61 deputetë, të cilët do të votojnë për votimin e projektligjeve.

Ndërkohë Zenun Pajaziti e ka kërkuar fjalën, po ju lutem deputetë në mënyrë që të kemi kuorum prej 61. Urdhëro, i nderuar deputet!

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Unë dëshiroj të shpreh shqetësimin tim për rastin e djeshëm të gjyimit të ish-ushtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Nuk është e zakonshme dhe nuk do të duhej të bëhej e zakonshme që në Kuvend të debatoheshin rastet ose vendimet e organeve të drejtësisë, po ajo që ndodhi dje pas një procesi të gjatë dhe të politizuar ka shkaktuar shqetësime të jashtëzakonshme të qytetarëve, jo vetëm të atyre që kanë qenë pjesë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, por te të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës. Këto vendime të djeshme kanë shkaktuar po ashtu shqetësime edhe në proceset tjera, ato që i kemi dëgjuar dje edhe nga mbrojtja, edhe nga ata që janë marrë me këto procese, me të vërtetë shkaktajnë shqetësime të mëtutjeshme dhe janë në prag të proceseve të rëndësishme, që unë mendoj që duhet t'i thërrasim nga këtu të gjithë për gjakftohtësi. Të kërkojmë nga gjithë ata që janë në mbrojtje të tyre, në mbrojtje zyrtare, të merren në shkallën tjetër edhe më shumë me mbrojtjen e tyre dhe t'i ftojme të gjitha organet e drejtësisë dhe sidomos ata që u morën deri tash me të, që të jenë sa më larg politikës, që pjesëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës të gjykohen drejt dhe pa ndërhyrje politike.

Po ashtu, edhe një herë dëshiroj t'u bëjë thirrje të gjithë qytetarëve, meqë me të vërtetë edhe ne e ndajmë shqetësimin me ta, që t'u lëmë hapësirë organeve të drejtësisë që eventualisht t'i korrigjojnë ato që i dëgjuam dje në organet e Gjykatës në Mitrovicë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, Zenun! Realisht, dita e djeshme ka qenë e rëndë për të gjithë ne. Tani futemi në seancë plenare.

Të nderuar deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

I hapi punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Avokatin e Popullit

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

E ftoj kryetaren e Komisionit FunkSIONAL për të Drejtat e Njeriut, zonjën Lirije Kajtazi, që para deputetëve ta paraqesë dhe arsyetojë raportin me rekomandime.

LIRIJE KAJTAZI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Edhe sot e kemi në lexim të dytë të ligj të rëndësishëm, i cili promovon të drejtat e njeriut dhe Komisioni FunkSIONAL për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione si Komision FunkSIONAL, bazuar në nenin 57, 67 dhe 68 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, ka punuar në amendamentimin e këtij projektligji, duke e bartur edhe te komisionet kryesore.

Ne jemi të vetëdijshëm që një kohë më reale do ta bënte një vëmendje më të shtuar dhe do të bënte kycjen e shumë personave, të cilët do ta kishin ndihmuar, apo të grupeve të interesit të cilët do të kishin ndihmuar për ta pasuruar më mirë ligjin, por për kohën sa e kemi pasur në dispozicion, në mungesë edhe të një dëgjimi publik, të cilin e kemi parë të nevojshëm, ngase është një komision që prek secilin qytetarë dhe avancon të drejtat e njeriut, i kemi ofruar amendamentet, të cilat besoj i keni në materiale dhe do të ecim tutje. Unë ju ftoj që ato të përkrahen. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zonja Kajtazi! Në këtë projektligj janë propozuar gjithsej 15 amendamente. Ne do të shkojmë me votimin e amendamenteve të propozuara sipas radhës së paraqitur në raportin e Komisionit FunkSIONAL.

Në sallë i kemi aktualisht të pranishëm 74 deputetë. Në fakt janë 76. Ne do të shkojmë amendament për amendament me ngritje dore për aprovimin e tyre.

Amendamenti 1

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 2

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 3

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 4

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 5

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 6

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 7

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 8

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 9

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 10

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 11

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 12

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 13

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 14

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 15

Kundër, ju lutem! Administrata, ju lutem, edhe pjesën e djathtë! Urdhëro, zonja Kajtazi!

LIRIJE KAJTAZI: Faleminderit, kryetar!

Në konsultime edhe me kryetarin e Komisionit për Buxhet dhe me sugjerime edhe të komisioneve tjera të përhershme, e kemi parë që është më e nevojshme të mbetet ashtu siç është në projektligj dhe Komisioni për të Drejtat e Njeriut e tërheq amendamentin 15.

KRYETARI: Atëherë kemi një propozim të kryetares së Komisionit Funksional. Shkojmë me votim elektronik kush është për, kundër, abstenim.

E patëm propozimin e kryetares së Komisionit Funksional, ju lutem për vëmendje. Unë e ripërsëris pra edhe një herë.

Synohet tërheqja e amendamentit 15. Jemi gjithmonë duke votuar për propozimin e kryetares së Komisionit Funksional. Do të votojmë në mënyrë elektronike.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Kanë votuar 75 deputetë, të gjithë kanë qenë për propozimin e kryetares së Komisionit Funkcional. Kështu që kemi largimin e këtij amendamenti nga projektligji, të cilin do ta votojmë tani në tërësi.

E votojmë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara.

Lus regjinë dhe deputetë të përgatiten për votim, votojmë për projektligjin në tërësi. Votojmë tash!

Kemi 76 deputetë që kanë votuar, 68 janë për, 1 është kundër dhe kemi 7 abstenime.

Konstatoj se Kuvendi e miratoi Ligjin për Avokatin e Popullit.

2. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mbrojtjen nga diskriminimi

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

E ftoj raportuesen e Komisionit Funkcional për të Drejtat e Njeriut, zonjën Teuta Haxhiu, që para deputetëve ta paraqesë dhe arsyetojë raportin me rekomandime.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione e ka shqyrtuar Projektligjin për mbrojtjen nga diskriminimi dhe i fton të gjithë deputetët t'i votojnë amendamentet e propozuara nga komisioni. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në këtë projektligj janë propozuar 9 amendamente. Vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara sipas radhës së paraqitur në raportin e Komisionit Funkcional.

Zoti Armend Zemaj e ka kërkuar fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetar!

Këto raporte janë shqyrtuar edhe në Komisionin për Legjislacion, po për hir të korrektësisë dhe raportit me komisionet tjera që i kemi, edhe në hartimin teknik, ta quaj legjislativ, amendamenti një nuk ka kuptim në të tri projektligjet, sepse ka të bëjë me siç thotë: “Me këtë amendament miratohen të gjitha përmirësime gjyqësore”, që nënkupton nuk ka përmirësime gjyqësore me amendamente. Është Zyra për Standardizim dhe është vetë komisioni se çka përmirëson dhe çka rregullon. Përmirësimet gjyqësore nuk mund të jenë pjesë e një projektligji.

Andaj, kjo nuk e ka vendin as në këtë Ligjin për diskriminimin, as për barazi gjinore, por as në atë që e miratuam për Avokatin e Popullit.

KRYETARI: Faleminderit! Urdhëro zonja Haxhiu, e keni kërkuar fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Gjithashtu, siç u tha më përpara, Komisioni për Legjislacion e ka shqyrtuar edhe këtë projektligj, pra nëse amendamentet e propozuara kanë bazë kushtetuese apo jo. Me gjithë faktin që kam kërkuar nga anëtarët e komisionit që të jenë më të vëmendshëm në trajtimin e këtyre amendamenteve, nuk e kanë parë një gjë të tillë dhe tash po bëjnë vërejtje në seancë plenare. Mirëpo, tash rekomandimi i komisionit është që ato janë në harmoni dhe në përputhje.

Pra, qëndrimi i zotit Zemaj është dashur të thuhet në Komisionin për Legjislacion dhe më pas komisioni t'i bëjë vërejtje Komisionit për të Drejtat e Njeriut, e jo tash në seancë plenare, sepse kjo nuk ka kuptim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Shkojmë në procedim të amendamenteve.

Amendamenti 1

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 2

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 3

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 4

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 5

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 6

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 7

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 8

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 9

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

E votojmë tekstin e projektligjit në tërësi dhe amendamentet e miratuara.

Lus regjinë dhe deputetë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

I kemi 74 deputetë, 73 vota për dhe një abstenim. Konstatoj se Kuvendi e miratoi Ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi.

3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për barazi gjinore

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

E ftoj kryetaren e Komisionit FunkSIONAL për të Drejtat e Njeriut, zonja Lirije Kajtazi, që para deputetëve ta paraqesë dhe arsyetojë raportin me rekomandime.

LIRIJE KAJTAZI: Faleminderit, kryetar!

Siç i keni përpara amendamentet, Komisioni FunkSIONAL ka punuar që ta ofrojë këtë prezantim dhe e keni parë që pa dashur me qenë shumë pretencioz, shifrat që flasin për pabarazinë 40%, zëvendësohen me shifrën 50%. Këtë duhet t'ia rikujtoj këtij Kuvendi, e kemi nxjerr nga rekomandimet, të cilat kanë dalë në Legjislaturën e kaluar pas monitorimit të Ligjit për barazi gjinore dhe një nga rekomandimet kryesore ka qenë edhe kjo që pabarazi quhet ajo kur shifrat bien nën 50, e jo nën 40%, prandaj amendamentet janë këtu, besoj që i shikoni me kujdes.

Njëkohësisht jemi kujdesur që Agjencia për Barazi Gjinore të mbetet në Zyrën e Kryeministrit. Këto ndoshta kanë qenë çështjet më esenciale, ndërkohë që vërejtjet tjera të përshkruhen në çdo amendament, një për një. Unë ju ftoj për votim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Atëherë në këtë projektligj janë propozuar gjithsej 10 amendamente. E kemi rekomandimin e Komisionit FunkSIONAL për t'i votuar.

Vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara sipas radhës së paraqitur nga Komisioni FunkSIONAL.

Amendamenti 1

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 2

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 3

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 4

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 5

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 6

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 7

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 8

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 9

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 10

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Miratohen të gjitha amendamentet. E votojmë në tërësi tekstin e projektligjit me amendamentet e propozuara. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Kanë votuar 72 deputetë, 66 për, 6 kundër. Miratohet Ligji për barazi gjinore nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për gjykatat

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar projektligjin dhe i kanë rekomanduar Kuvendit miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

E ftoj kryetaren e Komisionit Funksional, zonjën Albulena Haxhiu, që ta paraqesë raportin me rekomandime. Armend, urdhëro!

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetar!

Edhe në emër të komisionit dhe me vëmendjen e të gjithë anëtarëve të komisionit, ne kemi punuar në kohën që është paraparë nga shmangia e procedurave të Rregullores së Kuvendit dhe më lejoni të theksoj që në grup punues, përpos anëtarëve të komisionit, sepse edhe ligji, duke marrë parasysh rëndësinë e veçantë që kanë këto plotësim-ndryshime në sistemin e drejtësisë, kanë marrë pjesë edhe përfaqësues nga Zyra e BE-së në Kosovë, USAID-i, shoqëria civile, shumë organizata të saj, Prokuroria e Shtetit, Këshilli Gjyqësor, Këshilli Prokurorial, sponsorizuesi, Qeveria, Ministria e Drejtësisë dhe theksoj që të gjithë aktorët e interesuar kanë qenë pjesë. Po ashtu, edhe komisioni ka angazhuar edhe ekspertë të vetët.

Raporti përfshin disa amendamente, të cilat nuk janë të shumta në numër dhe unë e ftoj Kuvendit që këto t'i miratojë. Domethënë, janë tërësisht 11 amendamente në plotësim-ndryshimin që ka ndodhur, që janë kërkuar dhe janë miratuar në lexim të parë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Atëherë, e kemi rekomandimin e Komisionit Funksional për votimin e tyre, ndërkohë Sasha e ka kërkuar fjalën.

SASA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala predsediče!

Ja samo želim da objasnim zbog čega ćemo glasiti protiv ovog zakona, mi kao poslanička grupa Srpske liste, i ne samo protiv ovog zakona, nego mi ćemo danas da glasamo protiv Zakona o sudovima, protiv Zakona o sudskom savetu Kosova, protiv Zakona o tužilaštvu, protiv Zakon o državnom tužiocu, i protiv Zakona o naknadi žrtava zločina.

Mi kao Srpska lista danas ćemo u znak protesta zbog toga što se srpska verzija ovih zakona je veoma loše urađena sa izrazimo koji je u srpskom jeziku, posebno u srpskom pravednom jeziku ne postoji, što ove zakone čini veoma teškim za razumevanje, i što još opasnije pokušava da menja pravnu terminologiju koju srpski pravници koriste, što bi na duži rok učinilo veoma nepristupačno bilo kome ko ne poznaje smisao i duh albanskog jezika, na osnovu kog su izrađene ove reči koju u srpskom jeziku nema. Ovo je konstantan problem na koji upozoravamo već duže vreme, ali on se unazad svih ovih godina ne rešava.

I ovo je jedan od načina na koje želimo da skrenemo pažnju kosovskim institucijama da ispravno koriste srpski jezik kao jedan od službenih jezika na Kosovu. Želim da kažem i to da mi nismo protiv ovih zakona u suštini, niti smo protiv procesa vizne liberalizacije. Ali kao što sam rekao, ovo je jedan od načina na koju želimo da skrenemo pažnju svim kosovskim institucijama, da te institucije počne da počnu da koriste srpski jezik ispravno kao jedan od zvaničnik jezika na Kosovu. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit, Sasha! Armendi e ka kërkuar fjalën për sqarime.

ARMEND ZEMAJ: Ndoshta kjo çështje është më shumë teknike, sepse Ligji për gjuhët zyrtare u garanton të gjithëve këtu që jetojnë dhe punojnë të jenë në harmoni, por anëtarja që vjen nga komuniteti serb ka qenë në ditën finale pjesëtare e grupit punues, përpos mospjesëmarrjes saj, ne jemi munduar, sepse kjo çështje është ngrehur edhe aty për shkak problematikave që kanë qenë me përkthim, normalisht që është e drejtë dhe unë nuk e kontestoj, por gjatë hartimit të amendamenteve dhe procedimit final, deputetja ka qenë e pranishme dhe e ka pasur përkthimin zyrtar. Tash këto çështjet teknike të formulimit, edhe gjuhësor, e ku ta di unë, nuk mendoj që duhet të jenë arsye për mosvotimin e këtyre projektligjeve. Nëse diku kanë problem me një amendament të caktuar, ose kanë nevojë për sqarim, ne jemi këtu dhe mund ta sqarojmë në çfarëdo versionit qoftë ai, anglisht, shqip, serbisht dhe turqisht, apo në ndonjë gjuhë tjetër.

KRYETARI: Faleminderit! Arbeni e ka kërkuar fjalën po ashtu.

ARBEN GASHI: Faleminderit!

Që të mos krijohet një situatë e refuzimit, mendoj që nëse e kanë një problem konkret grupi i deputetëve nga komuniteti serb le ta diskutojmë dhe le ta zgjidhim si problem, përndryshe si Kuvend mund t'i japim përgjegjësi Sekretarisë së Kuvendit që t'i përshtatë në aspektin gjuhësor dhe shqetësimet, të cilat i kanë parasysh deputetët nga radhët e komunitetit serb, të merren në konsideratë dhe të eliminohen.

Përndryshe, nuk mendoj se ka diçka për të cilën duhet votuar kundër. Kështu që nëse ka një shqetësim konkret, një amendament, diçka që mungon, që është përmbajtjesore dhe e dëmton interesin e komunitetit serb ta diskutojmë. Përdërisa nuk ka diçka të tillë, janë çështje teknike, që mund t'i tejkalojmë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Para se të procedojmë, kam para vetes një shkresë të nënshkruar nga kryetarja e komisionit, Jasmina Zhivkoviç, e cila i jep amendamentet e propozuara nga Komisioni Funkcional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe

Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit se nuk i cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

E kisha ftuar, për hir të korrektësisë, zotin Sasha Milosavljeviq, që vërejtjet e deputetëve të cilët u dhanë, në qoftë se kanë diçka konkrete specifike, në ndonjërin amendament, ka gatishmëri t'u përshtatet. Apo të procedojmë:

Albulena e ka kërkuar fjalën, pastaj Jasmina!

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, shumë!

Janë dy çështje që desha t'i diskutoj. E para rekomandimi i Komisionit për të Drejtat e Njeriut, që nuk pakësojnë dhe cenojnë interesat e komuniteteve dhe, e dyta, në Komisionin për Legjislacion, secilin prej këtyre amendamenteve të secilit projektligj e kam lexuar dhe nuk kemi pasur kundërshtime nga përfaqësuesi i Listës serbe në Komisionin për Legjislacion, pasi e ka kuptuar esencën e një amendamenti, sepse e kam lexuar secilin prej këtyre amendamenteve. Kështu që unë nuk besoj që ka nevojë që të mos procedojmë tutje, vetëm po ju thërras që t'i votojmë amendamentet e komisionit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Zhivković ka kërkuar fjalën.

JASMINA ŽIVKOVIĆ: Poštovane kolege!

Očigledno je došlo do nesporazuma, a ja tražim od svih razumevanje za ono što smo mi objasnili. Ne radi se o suštinskom problemu svih ovih zakona, i nismo mi protiv suštinskih rešenja ovih zakona, ali sam duh zakona se menja kada se koristi u pravnom i srpskom jeziku. Daću vam jedan primer u jednom zakonu, u Zakonu o nadoknadi nad žrtvama zločina, koristi se jedna reč koja je na srpskom jeziku verski praznik - preobraženje, tako da to stvara zabunu pri primeni.

Na ovaj način, mi ne želimo da stopiramo nijedan sistem nijedan dalje postupak, jedino želimo da skrenimo pažnju da se srpski jezik koristi u pravom duhu, i u pravom smislu tog jezika. Drago mi je što kolege reaguju, i nadam se da će to pokrenuti proces da se jezik koristi u ispravnom obliku. Hvala!

KRYETARI: Ok-ej! Na po e shohim që nuk ka ndonjë vërejtje, po i referohem zonjës Zhivković në thelbin e këtij projektligji. Atëherë është mirë që me Administratën që ato aspektet, të cilat kanë të bëjnë më tepër me teknike dhe gjuhësore, t'i rregullojmë bashkërisht. Ne e procedojmë këtë projektligj.

E ka edhe një reagim zonja Zhivković. Urdhëro, zonja Zhivković!

JASMINA ŽIVKOVIĆ: Naravno da treba da nastavimo sa procesom, i ne bih ovo pitanje upotrebu jezika nazvala samo tehničkim pitanjem, zato što se sve ove svodi na tehničku pitanje dolazi do lakih problema, ovakve vrste prevoda i ovakvih dokumenta na srpskom jeziku. Mislim da se trebamo usredsrediti na samom suštini upotrebu jezika, a ne svoditi samo na tehničko pitanje i samo kao prevod. A naravno da se mi slažemo da se mi slažemo da trebamo da nastavimo sa procesom i da izglasamo ove zakone. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! E konsumuam debatin, futemi drejt votimit të amendamenteve.

Amendamenti 1

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 2

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 3

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 4

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 5

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 6. Kemi abstenim të 14 vetave, por të lutem ma jep pranimë e deputetëve në sallë për arsye se më duhet. Atëherë, të pranishëm janë 92 deputetë, 14 kanë abstenuar. Domethënë miratohet.

Amendamenti 7

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 8

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 9

Prapë e kemi të njëjtin rezultat, 92 deputetë, 14 abstenime. Miratohet.

Amendamenti 10

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 11

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Shkojmë në votimin e tekstit të projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash.

87 deputetë kanë votuar, nga të cilët 7 ka qenë kundër, 1 ka abstenuar, 79 për, Kuvendi miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për gjykatat.

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet propozuara.

Ftoj kryetaren e Komisionit Funkcional për Legjislacion, zonjën Albulena apo Donikën. Fjalën e ka zonja Donika Kadaj-Bujupi, për ta paraqitur dhe arsyetuar para deputetëve raportin me rekomandime.

DONIKA KADAJ – BUJUPI: Faleminderit!

Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, po ashtu në këtë proces të përshpejtuar të ndryshimeve dhe plotësimeve të ligjeve përkatëse, i ka paraqitur raport Kuvendit edhe për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe në emër të Komisionit ju thërrasim që t'i votoni 14 amendamentet e përkrahura dhe të propozuara nga Komisioni përkatës. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z.Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Faleminderit! Po vazhdojmë... Zonja Haxhiu e ka fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit! Unë kam vërejtje vetëm për një amendament dhe do ta arsyetoj votën kundër të Lëvizjes “Vetëvendosje” për amendamentin numër 7, i cili thotë që anëtarët e Këshillit nuk mbajnë përgjegjësi penale për vendimet, mendimet dhe veprimet brenda fushëveprimit të tyre si anëtarë të Këshillit.

Unë mendoj, që ky amendament është i padrejtë. Këtë e kam kundërshtuar edhe në Komisionin për Legjislacion, sepse secili duhet të ketë përgjegjësi, qoftë individuale, qoftë penale, për çfarëdo veprimi ose vendimi që merr.

Kësisoj ne, amendamentin 7 nuk e përkrahim si të tillë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Por, është mirë që të diskutohet kur të vijë amendamenti po... në rregull, e merr edhe njëherë fjalën, kërkon që të mos votohet, ose të votohet... Zoti Zemaj, e do ti pastaj...

Amendamenti 1

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 2

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 3

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 4

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 5

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 6

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Tek amendamenti i shtatë janë paraqitur Albulena, Armendi, edhe kush ishte tjetër? Zoti Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryesues!

Për hir të korrektësisë ndaj kolegëve deputetë tjerë dhe shqetësimit, që ka paraqitur kryetarja e Komisionit në emër të grupit të Lëvizjes “Vetëvendosje”, ne kemi shkuar strikt, s’po dua ta quaj në disiplinimin, qoftë sanksionimin, me norma ligjore, qoftë në Ligjin për Gjykatat, Këshillin Prokurorial, Këshillin Gjyqësor, por shprehja e mendimeve në fushëveprimtarinë që i takon nuk mund të jetë vepër penale.

Kjo është sikur për mendimet e shprehura në Kuvend dhe për votimet që merren, të ndiqen penalisht. Domethënë, ky është arsyetimi pse ne e kemi parë të arsyeshme, që të mbetet ashtu siç është në projektligj. Anëtarëve të Këshillit Gjyqësor, për vendimet e tyre, të cilat miratohen sipas rregulloreve të brendshme u nënshtrohen vetëm Komisionit Disiplinor të brendshëm, por, nuk mund të ndiqen në mënyrë individuale apo në mënyrë penale për mendimet e shprehura apo për vendimet që i marrin në mënyrë kolegjiale.

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Haxhiu e ka fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Unë edhe njëherë po e lexoj amendamentin, siç e ka përpiluar Komisioni për Legjislacion.

Këtu nuk flitet vetëm për mendimet, mirëpo këtu thuhet: “Anëtarët e Këshillit nuk mbajnë përgjegjësi penale për vendimet, mendimet dhe veprimet brenda fushëveprimit të tyre, si anëtarë të Këshillit.”

Atëherë, është dashur të hiqen “vendimet” dhe “veprimet” dhe të mbeten vetëm mendimet. Pra, kështu ne nuk e përkrahim këtë amendament.

KRYESUESI: Zoti Zemaj, e ka fjalën prapë.

ARMEND ZEMAJ: Prapë kjo është atë çka po e kërkon kolegja, sepse “mendimet” është edhe diçka më e përgjithësuar, domethënë ne këtu po i fusim veprimet, domethënë, që ka të bëjë edhe vendimet, gjithmonë brenda fushëveprimtarinë së Këshillit Gjyqësor, nuk po flasim për ato jashtë çka ndodhin dhe kjo është “heqjet individuale” domethënë, është vetëm përndjekje nga ndjekja penale.

Dhe, ju kisha lutur Kuvendin, që ta miratojë kështu siç është. Domethënë, nuk po shpikim ne diçka, po është e rregulluar në gjithë sistemin gjyqësor të vendeve më demokratike, sepse nëse ne i ndjekim penalisht për një mendim që thotë një anëtar i Këshillit Gjyqësor, dikush që mund ta ndjekë penalisht, atëherë ai nuk do të diskutonte asnjëherë në Këshill Gjyqësor, ose për një vendim që mund të jetë brenda fushëveprimtarisë së vet.

KRYESUESI: Logjika ime për gjyqtarin është që s'ka nevojë të japë fort mendime të lira, por mendimet në bazë të ligjit i jep edhe vepron në bazë të ligjit. Në qoftë se, shkel ligjin ai duhet të japë përgjegjësi. Nuk duhet të jetë pa përgjegjësi, por sidoqoftë ne po vazhdojmë diskutimin.

Zonja Kadaj-Bujupi, a e kërkoje fjalën edhe ti për këtë amendament? Atëherë, zonja Bujupi e ka fjalën.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Po, i nderuar nënkryetar!

Keni plotësisht të drejtë, e kemi thënë edhe këtu në seancë dhe kemi provuar edhe në Komision ta mbrojmë bashkë me përfaqësuesit e Lëvizjes “Vetëvendosje”- është e pakuptimtë amnistia, e cila i jepet gjyqtarëve përmes këtij neni.

Prandaj, i thërras edhe njëherë kolegët deputetë, që ta shqyrtojnë me vëmendje, para se të vendosin se si të votojnë.

KRYESUESI: Atëherë, zoti Zemaj, hajde ti edhe një herë.

ARMEND ZEMAJ: Veç të jemi të qartë. Nuk ka amnisti, këtu. Ata janë gjyqtarë, zoti kryesues, nuk janë njerëz të thjeshtë, janë gjyqtarë që marrin vendime gjyqësore. Dhe, e dimë edhe mënyrën edhe kush janë kriteret, e tjera.

Këtu ka të bëjë me punën e tyre dhe fushëveprimtaria e tyre brenda Këshillit Gjyqësor, sepse ajo ua garanton edhe me Kushtetutë. Lexojeni edhe Kushtetutën, është e garantuar, mbi të gjitha, është e garantuar edhe me një kërkesë që e ka bërë Qeveria për imunitetin e të gjitha institucioneve për vendimet që marrin në fushëveprimtarinë e tyre. Nuk amnistohet askush nga ndjekja penale.

KRYESUESI: Unë e kisha idenë që janë institucion, që nuk ka nevojë për shumë publikim dhe s'kanë nevojë për greva, as s'ka nevojë për shou medial në Këshillin Gjyqësor. Kjo është ajo që unë mendova, por sidoqoftë, unë do të hedh në votim amendamentin e shtatë, që është amendament i Komisionit dhe, votojmë me elektronikë. Kush është për, kush është kundër, pastaj votojmë propozimin e zonjës Albulenë.

Atëherë, votojmë amendamentin e shtatë me elektronikë. Votojmë tash.

Konstatoj se me 53 vota për, 3 abstenime, 28 vota kundër, miratohet amendamenti 7.

Tani propozimet e zonjës Albulenë, nuk po i qesim në votim hiç, u pa kjo punë.

Amendamenti 8

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 9

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 10

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 11

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 12

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 13

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 14

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Votojmë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Votojmë tash!

Konstatoj që me 62 vota për, 5 abstenime, 12 vota kundër, Kuvendi miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës.

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara. Ftoj kryetaren e Komisionit Funkcional për Legjislacion, zonjën Haxhiu, që para deputetëve të paraqesë dhe arsyetojë raportin me rekomandime. Zonja Haxhiu, e keni fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Atëherë, Komisioni për Legjislacion në mbledhjen e mbajtur më 25.5.2015 e shqyrtoi Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe i ka përpiluar gjithsej 17 amendamente, në bashkëpunim edhe me grupet e interesit, shoqërinë civile, të cilët i falënderoj për punën dhe ndihmën që i kanë bërë Komisionit, gjithashtu edhe përfaqësuesit e institucioneve të drejtësisë.

Pra, ne kemi arritur që t'i përpilojmë 17 amendamente. Kësisoj, ftoj deputetët e Kuvendit, që t'i përkrahin të njëjtat.

Më lejoni t'ju informoj, që për shkak të kohës së shkurtër, Komisioni për Legjislacion, në përpilimin e këtyre amendamenteve i ka disa gabime teknike, mirëpo kur të vijmë te

amendamentet do t'i sqaroj dhe kërkoj përkrahjen tuaj. Gjithashtu, më duhet të them, që jam koordinuar edhe me anëtarët e Komisionit për këto që do t'i propozoj për amendamentin numër 5 dhe amendamentin numër 17. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara. Sipas radhës së paraqitur në raportin e Komisionit FunkSIONAL.

Amendamenti 1

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 2

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 3

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 4

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 5. Zonja Haxhiu e ka fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Atëherë, ky amendament ka për qëllim procedurat për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Prokurorial, pra është amendamenti i pestë dhe po ndalem vetëm te paragrafi 2.

Tre anëtarë jo prokurorë të Këshillit Prokurorial, të zgjedhur nga Kuvendi i Kosovës, sipas nenit 65 të Kushtetutës, zgjidhen me votim të fshehtë me votat e 61 deputetëve të Kuvendit.

Pra, e kemi pasur 61 vota për, për t'u zgjedhur anëtar i Këshillit Prokurorial, kështu që kërkoj vetëm që ta zëvendësojmë dhe le ta harmonizojmë edhe me ligjet tjera dhe le ta bëjmë kështu: "Me shumicën e të gjithë deputetëve të Kuvendit.", që nënkupton 61. E kam këtu edhe konfirmimin e administratës së Kuvendit, që ka njohuri dhe profesionalizëm për këto çështje dhe, kjo është pra vetëm një korrektim gjuhësor, që t'u përshtatet ligjeve dhe Rregullores. Faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e ka kërkuar ministri i Drejtësisë, zoti Kuçi.

MINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Anëtarë të Qeverisë,

Në këtë amendament, natyrisht që propozimet që ka dhënë Komisioni me shumicën e tyre edhe pajtohem, por mendoj se në pikën e pestë, neni 5, pika 1.1.4, ku thuhet që një prokuror nga Zyra e kryeprokurorit të shtetit, të theksohet që të jetë kryeprokurori i shtetit. Dhe, këtu i kam disa arsye.

E para, besoj se Këshilli Prokurorial i Kosovës nuk është mirë të funksionojë pa qenë prezent edhe kryeprokurori i shtetit dhe unë mendoj që në dy drejtime: e para po e marrim shembull, sikur në Universitet, Këshilli Drejtues të mos ishte prezent rektori apo edhe në ushtri, po e them, Shtabi i Përgjithshëm, pa qenë komandanti. Dhe, ne e dimë po ashtu, që në këtë rast, e kemi rastin konkret, që kryeprokurori i shtetit e ka fuqinë e vet edhe në subordinimin e koordinimit të punëve, por edhe përgjegjësinë.

Andaj, unë ju ftoj, që pika 1.1.4, ku thuhet: “një prokuror nga Zyra e kryeprokurorit të shtetit”, të thuhet: “një kryeprokuror i shtetit”. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit!

Ne tash... ka qenë pikërisht, ministër, Komisioni që ka kërkuar pse nuk është kryeprokurori, por propozimi ka ardhur nga sponsorizuesi kështu, në këtë formë. Dhe, ne vetëm e kemi mbrojtur.

Bile- bile edhe ekspertë dhe të tjerë kanë kërkuar që kryeprokurori ta ketë një të deleguar nga zyra e kryeprokurorit të shtetit dhe ky të jetë prapë anëtar, domethënë që është i këshillit, pa të drejtë vote. Nëse mendojmë ndryshe, domethënë, krejt kjo çka është, nuk ka qenë që ne tash e kemi eliminuar. Bile- bile kur kemi biseduar edhe te vota kemi thënë, a për t'i dhënë drejtë vote, apo për të mos i dhënë të drejtë vote. Ka pasur propozime, unë kam propozuar pse për të mos jetë me të drejtë vote, tjerët kanë qenë - po e ka përfaqësuesin e zyrës së vet dhe ai e ka drejtë vote.

Atëherë, kryeprokurori i shtetit i ka dy vota, e ka votën e vet dhe të përfaqësuesit të tij. Nëse eliminohet njëri, atëherë le të mbetet ashtu siç po thoni ju, që të jetë kryeprokurori i shtetit, po jo edhe një i deleguar nga ai.

KRYESUESI: Zoti Kuçi kërkon sqarim shtesë.

MINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit!

Zoti Zemaj, besoj që atakuat tamam atë që edhe e mendova. Ne po e themi, pika 1.1.4. kur thuhet, po e bëj si është dhe si duhet të jetë: 1 prokuror nga Zyra e kryeprokurorit të shtetit. Thuhet kështu: Kryeprokurori i shtetit. Dhe, nuk ka nga kryeprokurori i shtetit tjetër. Faleminderit!

KRYESUESI: Zonja Haxhiu e ka fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

E kemi diskutuar shumë gjatë këtë çështje në Komisionin për Legjislacion, sepse propozimi që ka ardhur nga Ministria e Drejtësisë, ka qenë që kryeprokurori të jetë anëtar pa të drejtë vote në Këshillin Prokurorial. Dhe, tash, me vetë propozimin e kryeprokurorit, jo ai vetë, por përfaqësuesi i tij, na ka thënë që nëse nuk kam të drejtë vote më mirë që të mos jam fare anëtar në KPK dhe kjo është arsyeja se pse Komisioni për Legjislacion e ka hequr komplet kryeprokurorin. Mirëpo, në parim nuk është asnjë problem që kryeprokurori i shtetit të jetë anëtar i KPK-së me të drejtë vote. Faleminderit!

KRYESUESI: Atëherë, po e fus në votim amendamentin 5, me propozimin shtesë që kryeprokurori të jetë anëtar i Këshillit Prokurorial me të drejtë vote. A është kështu? Do të thotë me propozimin e ministrit.

(Ndërhyrje)

Pra, pika 1.1.4. në vend të - një prokuror nga Zyra e Kryeprokurorit, të jetë Kryeprokurori i Shtetit.

Po, urdhëroni! Zoti Zemaj e do fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Unë kisha kërkuar, për hir të asaj që edhe i takon si kryeprokuror, pika 1.1.4. le të jetë e para, do të thotë, sepse ky është kryeprokuror dhe për shkak të rëndësisë të jetë anëtar i parë nga ajo dhjetëshja, do të thotë teknike. Ne po e marrim që të jetë kryeprokurori i shtetit, por të jetë pika e parë pas 10 anëtarëve që janë nga numri i anëtarëve për Këshillin Prokurorial.

KRYESUESI: Faleminderit! Nëse edhe Komisioni nuk ka diçka kundër, mendoj ta hedhim në votim bashkë me propozimin e Armendit dhe të kryeministrit...

(Ndërhyrje)

Po, edhe i korrigjimit që u bë...

Pra, të jetë shumica e deputetëve, jo numri 61. Në rregull. Atëherë e hedh në votim amendamentin.

Amendamenti 5

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 6

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 7. Ndalemi këtu, zonja Haxhiu e ka fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Atëherë më lejoni që ta jap qëndrimin e Lëvizjes “Vetëvendosje”, jo të Komisionit për Legjislacion, në raport me këtë amendament.

Këtu thuhet që kryetari i Këshillit, së paku një herë në vit, paraqet raporte publike vjetore për performancën, veprimet, kostot dhe nevojat buxhetore të sistemit prokurorial.

Pra, raporte publike. Mirë, por çka po bëhet me ato raporte publike, a duhet t’i procedojë ato raporte publike në Kuvend?

Sa i përket Këshillit Gjyqësor thuhet, në bazë të Kushtetutës po them, që kryesuesi i Këshillit Gjyqësor e njofton së paku një herë në vit Kuvendin, për punën ose për sistemin gjyqësor. Dhe, njësoj kam kërkuar që të jetë edhe për Këshillin Prokurorial.

Pra, kam kërkuar që kryesuesi i Këshillit Prokurorial, të paktën të një herë në vit t'i paraqesë sfidat në Kuvendin e Republikës së Kosovës, sfidat e sistemit prokurorial, mirëpo kjo nuk është përkrahur nga Komisioni për Legjislacion. Ky amendament është që ka ardhur nga Bashkimi Evropian dhe mendoj që ky është i paqartë dhe është i padrejtë. Kësisoj konsideroj që shumë më mirë kishte me qenë që kryetari ose kryesuesi i Këshillit Prokurorial atë raport ta sjellë në Kuvend dhe le ta diskutojmë, pa dashur të cenojmë në pavarësisë e tyre, vetëm le t'i diskutojmë sfidat e Këshillit Prokurorial.

Besoj se kemi pasur shumë probleme në të kaluarën dhe është tepër e rëndësishme që të ketë një qasje Kuvendi në këtë çështje.

Pra, unë në emër të Grupit po e potencoj edhe një herë, nuk e përkrahim amendamentin numër 7. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryesues!

Unë mendoj që amendamenti 7 është mirë dhe është në rregull, për hir të asaj që ne po e quajmë dhe po kërkohet kjo çkapja e shtetit. Thashë ose po e çkapim ose po e kapim.

Tash për ta kapur, po i bie kape njërin, lësho tjetrin, ose lësho njërin e kape tjetrin.

Domethënë, krejt ajo çka po domi, edhe pse na e kemi përkrahur këtë të BE-së, është me të vërtetë propozim i tyre, sepse në projektligj ka qenë ndryshe: kryetari i Këshillit së paku një herë në vit paraqet raport publik vjetor.

Raporti publik, përpos asaj rrugës që kërkohet të vijë deri në Kuvend, në mënyrë teknike, do të thotë, nuk paraqet ndonjë problematikë të caktuar, po as nuk e cenon pavarësinë e Këshillit Prokurorial, por as nuk e tejkalon përgjegjësinë e Kuvendit për të kërkuar përgjegjësi publike ndaj Këshillit Prokurorial.

Domethënë, mendoj se kjo është në rregull kështu si është, dhe duhet të përkrahet.

E dyta, që ka të bëjë me mos raportimin. Njëherë e përgjithmonë duhet të dimë se ndarja e pushteteve duhet të jetë mirë e rregulluar, qartë, edhe me Kushtetutë, por edhe me logjikën që mos të kemi ndikim, qoftë edhe ai formal, kështu që po besoj se kjo është në harmoni me krejt atë çka po kërkojmë çdo ditë dhe kështu duhet të përkrahet.

Nuk ka ndonjë logjikë që e përjashton nga përgjegjësia publike, bile- bile e kemi sanksionuar shumë përgjegjësinë, qoftë të prokurorit, tash me Ligjin për prokurorin e shtetit, po qoftë edhe me këtë ligj.

KRYESUESI: Faleminderit! Albulena e ka kërkuar prapë fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Unë nuk po mund të kuptoj se si mundet Kuvendin ta kapë shtetin. Shtetin e kap Qeveria, qysh e ke parë edhe deri tash.

Dhe, me një raport, ne si deputetë të Kuvendit nuk mund t'i dimë cilat janë sfidat e sistemit prokuroria nëse nuk e kemi një raport paraprak, me rekomandime për Kuvendin. Çdoherë Këshilli Prokurorial është ankuar për mungesë të buxhetit, mirëpo, është ankuar vetëm në mënyrë deklarative, nuk kemi pasur një raport as për buxhetin as për asgjë tjetër. Dhe, anëtarët e Këshillit Prokurorial paguhën me para të taksapaguesve tanë, ata e kanë obligim që të na raportojnë neve. Ndoshta fjala raportim do të hiqet, mirëpo të na njoftojnë për punën ose për sfidat e Këshillit Prokurorial.

Ky është qëndrimi i Lëvizjes “Vetëvendosje” dhe unë i ftoj që ta përkrahin qëndrimin e Lëvizjes “Vetëvendosje” ose mos ta përkrahin fare amendamentin numër 7, le të mbetet ashtu sikur që e ka propozuar Ministria e Drejtësisë.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kuçi e keni fjalën, nëse doni të bëni ndonjë sqarim shtesë.

MINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit!

Besoj se qëllimi është i njëjtë i të gjithëve që të jetë më transparente dhe llogaridhënëse puna e tyre, por mendoj që fjala raport duhet të hiqet, por duhet të jetë informim, në raport me pushtetet e ndara. Dhe, unë pajtohem pastaj që të jetë një gjë e tillë. Faleminderit!

KRYESUESI: Tani ne na ka rënë të shohim, sepse ne kemi probleme dhe me agjencitë e pavarura të cilat bëjnë raportime, por s'vijjnë të raportojnë në Kuvend dhe duhet ne të zhvillojmë debat e komisionet pastaj të merren me ta.

Ndoshta do të ishte mirë që të ketë një foltore të veçantë kur ka, ose të flasim diku...

(Ndërhyrje)

Unë, s'po di si ta rregulloj këtë, por sidoqoftë ju keni mendime, dhe dy mendime janë këtu, është i treti i zotit ministër që të hiqet raportim dhe të quhet informatë. Domethënë, unë sipas radhës së propozuesve në fillim, po e qes propozimin e amendamentit që e ka dhënë Komisioni e pastaj propozimin e Grupit Parlamentar “Vetëvendosje” në qoftë se votat janë të tilla, dhe kuptohet edhe të propozimit të ministrit për ta hequr fjalën raport dhe për ta bërë informatë.

Atëherë e votojmë amendamentin 7, me elektronikë, sipas propozimit të Komisionit funksional dhe votojmë tani.

Faleminderit! Janë 51 vota për amendamentin, ashtu sikur që është propozuar nga Komisioni funksional, 9 abstenime dhe 13 vota kundër.

Amendamenti 8

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 9

Për amendamentin 9, zonja Haxhiu e do fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Në emër të Komisionit për Legjislacion po flas. Amendamenti numër 9, për shkak të kohës që s'e kemi pasur në dispozicion dhe kemi bërë një gabim teknik, është mirë që ta qartësojmë amendamentin, në mënyrë që mos të kemi probleme në të ardhmen.

Neni 6 i Projektligjit, paragrafi 2 riformulohet si vijon: Anëtarët e Këshillit shkarkohen nga funksioni me 2/3 dhe në pajtim me Rregulloren e Këshillit. Kjo është për anëtarët e Këshillit që zgjedhën, pra anëtarët e Këshillit Prokurorial, përveç anëtarëve që zgjidhen nga Kuvendi dhe tash ajo çka kemi propozuar si Komision me shtua - e të cilët shkarkohen nga Kuvendi me propozim të Këshillit. Pra, fillimisht duhet ta kemi propozimin e Këshillit dhe më pas ta shkarkojë Kuvendi, sepse nëse i lihet Këshillit t'i shkarkojë edhe anëtarët që i zgjedh Kuvendi s'ka kuptim, sepse ata që i emërojnë ata edhe i shkarkojnë, kështu që propozimi është vetëm t'i shtohet fjalia – e të cilët shkarkohen nga Kuvendi me propozim të Këshillit.

KRYESUESI: Zonja Sahatqija e ka fjalën.

TEUTA SAHATQIJA: Faleminderit, zoti kryesues!

Në Komisionin për Integritet Evropian e kemi analizuar dhe pikërisht ky amendamenti numër 9 ishte amendament i cili u diskutua bukur gjatë dhe pati vërejtje sa i përket fjalëve, përveç anëtarëve që zgjidhen nga Kuvendi, te amendamenti 9, pasi që duke marrë parasysh planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve nga Raporti i Progresit PVRP 2015, tek pjesa 1.1.5 sistemi gjyqësor, thuhet që dispozitat e katër ligjeve të gjyqësorit, të cilat rregullojnë kriteret për emërimin dhe shkarkimin e prokurorëve dhe gjyqtarëve duhet të harmonizohen.

Në fakt, në ligje ekzistojnë mënyra të ndryshme dhe sa i përket integriteteve evropiane dhe planit të veprimit, mendojmë se këto do të duhej të ishin të dakorduara.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Gashi e ka fjalën.

ARBEN GASHI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Vetëm mora fjalën që të jap pakëz kontribut lidhur me këtë debatin që u zhvillua në Komisionin për Integritet Evropian dhe qëndrimi im edhe në Komision edhe këtu është që nuk mundet një institucion tjetër të ndryshojë vendimet e Kuvendit. Vendimi i Kuvendit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Prokurorial është vendim i Kuvendit dhe nuk mund Këshilli Prokurorial, me vendim të vetin, ta ndryshojë vendimin e Kuvendit.

Këtë vendim të Kuvendit, i vetmi autoritet që mund ta ndryshojë, është vetë Kuvendi, ndërsa, Gjykata Kushtetuese mund ta interpretojë, nëse vendimi i Kuvendit është në pajtueshmëri ose në kundërshtim me Kushtetutën dhe ta shfuqizojë si vendim për shkak të shkeljes së Kushtetutës, por jo një institucion si Këshilli Prokurorial i Kosovës, të ndryshojë vendimet e Kuvendit.

Prandaj, mendoj se Komisioni për Legjislacion e ka bërë, po edhe precizimi që e dha zonja Haxhiu është i mirë, dhe ndoshta mund të shkojë edhe përtej ajo që zoti Hamiti kërkoi që shkarkimi të bëhet me numrin e njëjtë të votave sikur që bëhet edhe emërimi, nëse ka nevojë, megjithëse për analogji nënkuptohet ajo. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Zemaj!

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit kryesues!

Tash mua po më vjen keq që ne s'po mund ta shpjegojmë krejt logjikën se si kemi punuar dhe pse kanë ardhur këto ndryshime.

Por, më lejoni të them se deri më tani edhe neni 65 i Kushtetutës e përcakton mënyrën e zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit Prokuroral, të cilët thotë zgjidhen nga Kuvendi.

Por, mënyrat e zgjedhjes për anëtarët e Këshillit Gjyqësor janë të rregulluara me Kushtetutë.

Neni 118 thotë që anëtarët e Këshillit Prokurorial rregullohen me ligj të veçantë.

Në kuadër të ligjit të veçantë, ne i kemi ndarë këto tri pozicione, tash ia kemi deleguar që këto i zgjedh Kuvendi. Dhe, kjo është arsyeja pse ka dalë tash, përveç anëtarëve që zgjidhen nga Kuvendi, kjo është për hir të asaj që e tha kryetarja e Komisionit për Integritet dhe e heq atë dilemën e ndërhyrjeve politike, që është në harmoni me Kushtetutën.

Ne kemi pasur deklarime se Komisioni i Venedikut thotë ndryshe, por Kushtetuta jonë është kështu deri më tani. Edhe ju e dini që ndryshimet kushtetuese nuk kanë kaluar në mandatin e kaluar, që kanë qenë për t'u hequr kjo përgjegjësi. Por, si do që të jetë, ne tash jemi në harmoni me Kushtetutën.

Krejt ajo çka po kërkojmë te pika këtu, ose te presja, çfarëdo qoftë, ta riformulojmë - përveç anëtarëve të cilët zgjidhen nga Kuvendi, me propozim të Këshillit Prokurorial. Propozimin për shkarkim e jep Këshilli Prokurorial, por mënyra e shkarkimit vjen me procedura të njëjta, me të cilat i ka emëruar Kuvendi. Kaq! Nëse ka diçka tjetër ministri, e pse e kemi rritur në 2/3, sepse nuk ka qenë e përcaktuar. Me këtë kem dashur që ta disiplinojmë edhe Këshillin Prokurorial, që nuk mund ta shkarkojë një anëtar të vetin pa 2/3 e votave. I kemi parë konfliktet që kanë qenë të hapura dhe mund të jenë edhe individuale, qofshin ato konceptuale, prandaj kemi dëshiruar që kjo të rritet në 2/3 nga numri i përgjithshëm prej 15 anëtarëve. Unë e kam këtë shpjegim. Ministër, urdhëro, nëse ke diçka tjetër, ose vetëm po e riformulojmë.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër Kuçi, e dëshironi fjalën?

MINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Unë personalisht mendoj që Kuvendi s'duhet t'i zgjedhë fare dhe unë besoj që kjo është çështje tjetër, por jam i bindur që kjo legjislaturë, ose tjetra, do ta ndryshojë prapë dhe do ta heqë këtë, se është ndërhyrje. Dhe po e them, shpeshherë u thanë edhe këtu, Kushtetuta thotë se mënyra e zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Prokurorial rregullohet me ligj. Për Këshillin Gjyqësor e

parasheh qysh zgjidhen, do të thotë kjo është e qartë dhe shpesh kemi herë kemi pasur ngatërresa në këtë drejtim juridik.

Çështja e dytë, nëse veç e parashohim kështu, propozimin mund t'ia japim Këshillit, por vendimin që e merr Kuvendi duhet prapë ta marrë Kuvendi. Është logjik juridike - ai që e emëron dhe e shkarkon. Se përndryshe po e them “konflikti më i madh” do të jetë ndërmjet atyre që i emëron Kuvendi dhe atyre tjerëve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Haxhiu e ka fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Atëherë vetëm një qartësim sa i përket Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Neni 65 kompetencat e Kuvendit, paragrafi 10, thotë: “Zgjedh anëtarët e Këshillit Gjyqësorë të Kosovës dhe të Këshillit Prokurorial të Kosovës në pajtim me këtë Kushtetutë”.

Dhe, te Kapitulli për Këshillin Prokurorial thuhet që procedurat përcaktohen me ligj dhe atë po e bëjmë. Pra, po i përcaktojmë procedurat e zgjedhjes së anëtarëve dhe në bazë të diskutimeve që kemi pasur jemi dakorduar që Kuvendi të mos i zgjedhë prokurorët, mirëpo anëtari nga Universiteti i Prishtinës, Shoqëria Civile dhe Oda e Avokatëve. Pra, ky ka qenë një konsensus në Komisionin për Legjislacion dhe tash unë po kërkoj që vetëm të qartësohet ajo që e përmenda më përpara dhe të jetë e kuptueshme për të gjithë. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Hamiti e ka fjalën.

SABRI HAMITI: Faleminderit, zoti kryesues!

Këtu jemi duke votuar nene, ligje, gjuhë precize, me ide ashikare, po pajtohemi të gjithë. Por, nëse ne tash duhet ta votojmë një variant të ndryshëm nga ky që e kemi këtu, flasim për amendamentin 9, atëherë unë besoj që rezymohet kjo që thamë ne, nëse thuhet “anëtarët e Këshillit të shkarkohen nga funksioni me 2/3 dhe në pajtim me Rregulloren e Këshillit”. Anëtarët që zgjidhen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës shkarkohen me propozim të Këshillit me shumicën e deputetëve të Kuvendit. Pikë! Besoj që i ka brenda shkurt të gjitha elementet që po kërkojnë. Unë e propozoj këtë formulim. Faleminderit!

KRYESUESI: Dakord! Atëherë e votojmë amendamentin 9, me propozimin që u dha që të jetë shtesë dhe që kishte një dakordancë, por ky formulimi që e bëri zoti Hamiti mendoj se ishte i mirë dhe në përputhje me atë që u diskutua.

E votojmë amendamentin 9. Votojmë tani!

Me 63 vota për miratohet amendamenti 9.

Amendamentin 10, me elektronikë. Votojmë tani!

Me 49 vota për, 3 abstenime dhe 14 kundër, miratohet amendamenti 10.

Amendamenti 11

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 12

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 13

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 14

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 15

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 16

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Hap debatin për amendamentin 17. Fjalën e ka ministri Kuçi.

MINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Besoj që për këtë amendament ka nevojë të bëhet një kompromis, po e quaj, ndërmjet asaj që është propozuar nga unë dhe asaj që është propozuar nga Kuvendi.

Më lejoni të them që neni 20, nenet 3, 4, 8 dhe 10, është propozuar që nga janari i vitit 2017 të hyjë në fuqi. Por, në ndërkohë pika 2 thotë që rregulloret e përcaktuara në këtë ligj duhet të miratohen brenda 6 muajve, përfshirë edhe Rregullorja për emërimin e anëtarëve të Këshillit Prokurorial. Edhe unë me dakordancën tuaj isha pajtuar që të jetë më 1 janar 2016, pra prej ditës së sotme e deri në atë kohë ka kohë të miratohet rregullorja.

Dhe, e dyta po them që në ndërkohë shpallet edhe ajo mundësia e konkursit që Shoqëria Civile t'i propozojë të tjerët, e t'i miratojë Kuvendi. Përndryshe, nëse miratohet ky amendament dhe hyn në fuqi pas 15 ditëve, nuk do të kemi Këshill Prokurorial. Pra, duhet të jemi të kujdesshëm në këtë drejtim. Pra, ta vazhdojmë deri më 1 janar 2016. Një kompromis i pajtueshëm, përndryshe zoti Zemaj, pajtohem se paraprakisht jeni pajtuar edhe ju.

(Reagime nga salla)

KRYESUESI: Edhe një herë fjalën zotit Kuçi.

MINISTRI HAJREDIN KUÇI: Profesor Sabri, nuk e kemi fjalën për krejt ligjin. Nuk është fjala për krejt ligjin më 1 janar 2016. Është fjala vetëm për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit, anëtarëve të rinj. Duhet të jemi të kujdesshëm se ka procedura, ka rregullore, duhet votim në Kuvend dhe për 15 ditë nuk mund t'i kryejë Kuvendi këto. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka kërkuar zoti Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Jo, mendova që ministri e ka ndonjë propozim tjetër. Nëse qëndron prapa propozimit 2017, ne e patëm atë. Propozimi nga sponzorizuesi ka qenë për vitin 2017. Ne kemi

menduar që të hyjë në fuqi menjëherë. Dhe ndryshimet që janë bërë në kuadër për përzgjedhjes, sepse janë edhe disa ndryshme tjera këtu që janë, e kemi eliminuar edhe atë pagën e dyfishtë, lejimin deri në 25%. Janë edhe disa gjëra që nuk u përmendën, e që janë ndryshuar dhe janë shumë esenciale, si dhe ajo që ka dalë nga leximi i parë.

Mendimi i komisionit është që t'i jepet mundësi, edhe pse Këshilli ekziston. Tash Këshilli nuk mund askënd ta eliminojë në mënyrë retroaktive, por, sido që të jetë, të precizohet 1 janar 2016, jo vetëm 2016, por 1 janar 2016.

KRYESUESI: Zonja Haxhiu e ka fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Në fakt, unë mendova që ma japë fjalën në emër të Komisionit për Legjislacion, sepse e mori Armendi, por s'ka rëndësi. Megjithatë, vetëm sa për ta qartësuar.

Ministria e Drejtësisë ka thënë 1 janar 2017, e nëse është kështu pse kemi nevojë që për një javë t'i bëjmë projektligjet, kur hyn në fuqi më 2017. Vetëm për të figurua si emërtim në Raportin e Progresit, apo diku tjetër, a? S'ka kuptim!

Për atë arsye, Komisioni për Legjislacion pati vendosur që menjëherë të hyjë në fuqi, pra ashtu siç është standard për të gjitha ligjet. Pra, ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Dhe, tash pas konsultimeve që i kemi pasur me anëtarët e Komisionit për Legjislacion, kemi rënë dakord që 1 janari 2016 të jetë hyrja në fuqi e këtij ligji.

Ne kemi dëgjuar se ministri do të propozojë sërish sot që të jetë viti 2017 kur ligji do të hyjë në fuqi, por mirë që e kanë ndryshuar mendimin dhe e përkrahim që të jetë 1 janar 2016. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Hamiti e ka fjalën.

SABRI HAMITI: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë po shoh që edhe komisioni po heq dorë nga amendamenti që e ka bërë vetë. Edhe ministria po heq dorë nga propozimi që e ka bërë vetë.

Unë vetëm, meqë m'u përmend emri, duhet të theksoj: Duhet të ndiqet një logjikë, nëse këto ligje, me arsye të shumta, edhe të asaj që quhet 'reformë e ligjeve themelore për drejtësinë', edhe të asaj që quhet 'për një funksion rreth liberalizimit të vizave', ne punojmë më shpejt, më ngutshëm, më intensivisht për një arsye, e kjo i bie që logjikisht duhet të hyjnë në fuqi më shpejt. E pikëpyetja ime ishte: pse atëherë të prolongohet hyrja në fuqi e tyre, nëse duhet të bëhen shpejt? Kaq! Po unë nuk kam çka them tjetër, sepse këta ashiqare u pajtuan tash të jetë 1 kallnori 2016, e unë për këtë nuk do të bisedoj më tutje.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kuçi e ka fjalën.

MINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, profesor Hamiti!

Nëse me lejohet, t'jua jap një sqarim, se ju keni të drejtë në kuptimin e përgjithshëm. Propozimi është kështu: nenet 3, 4, 8 dhe 10, jo pjesët tjera, pjesët tjera hyjnë në fuqi 15 ditë, dhe këto kanë të bëjnë me emërimin e anëtarëve të rinj të Këshillit Prokurorial, me kryesuesin dhe zëvendëskryesuesin e Këshillit Prokurorial, me miratimin më 1 janar 2016. Por, unë po e them, zoti Zemaj u pajtua paraprakisht, po e them publikisht, dhe unë e bëra për hir edhe të tij këtë kompromis, propozimi im ka qenë shumë racional.

Të mos i harrojmë dy gjëra: njerëzit janë të emëruar aty me mandat, t'ua marrësh mandatin nuk është bash lehtë. Ta kemi të qartë! Po ta dërgojë këtë lëndë dikush në gjykatë, ta keni të qartë se do ta fitojë se ai e ka mandatin 5 vjet dhe i përfundon në vitin 2017. Ne po pajtohemi, besoj që edhe anëtarët e Këshillit që e kanë një mandat të tillë nuk do të reagojnë, që 1 janari 2016 është i mjaftueshëm për të hyrë në fuqi.

KRYESUESI: Atëherë konstatojmë se sipas diskutimeve dhe propozimeve në nenin 20, nenet 3, 4, 8 dhe 10 do të fillojnë të zbatohen nga data 1 janar 2016, e në propozim ka qenë 1 janar 2017.

A jemi dakord. A ka kundër? Nuk ka kundër, miratohet.

E votojmë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Votojmë tani!

Atëherë i kemi 72 vota për, 7 vota kundër dhe asnjë abstenim.

Konstatoj që Kuvendi e miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës.

7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurorin e Shtetit

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara. Ftoj kryetaren e Komisionit Funksional për Legjislacion, zonjën Haxhiu, që para deputetëve ta paraqesë dhe arsyetojë raportin me rekomandime. Zonja Haxhiu, e keni fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Komisioni për Legjislacion, në mbledhjen e mbajtur më 26 maj 2015, e shqyrtoi Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit dhe pas diskutimeve, dëgjimeve në bashkëpunim edhe me Shoqërinë Civile dhe përfaqësuesit e institucioneve të drejtësisë i kemi përpiluar gjithsej 20 amendamente.

I ftoj deputetët e Kuvendit që t'i përkrahin si të tilla.

KRYESUESI: Faleminderit! Për amendamentin 19 janë dhënë dy propozime, të tjerat janë të Komisionit. Kur të vijmë te ai diskutojmë.

Amendamenti 1

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 2

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 3

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 4

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 5. Zoti Kuçi e ka kërkuar fjalën për amendamentin 5.

MINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit!

Unë mendoj që te amendamenti 5, që është fshirë pjesa që “Kryeprokurori i përgjigjet edhe Këshillit Prokurorial”, e duhet të shtohet. Dhe, ky propozim s’ka qenë krejt naiv.

E dini që propozimet për emërim i bënë Këshilli Prokurorial te Presidentja e vendit dhe ai organ prapë me propozimin e Kryeprokurorit të Shtetit mund ta propozojë zhdekretimin e tij, ose marrjen e mandatit. Pra, nuk mund t’ia marrim një kompetencë të tillë Këshillit Prokurorial dhe pak më herët e votuam një Ligj, kur thamë Këshilli Prokurorial i Kosovës emëron, disiplinon, shkarkon prokurorët. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! A ka mendim komisioni? Zonja Haxhiu e ka fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Po nëse është fjala për amendamentin 5, atëherë neni 5 i projektligjit, paragrafi 3, riformulohet si vijon: “Kryeprokurori është përgjegjës dhe për punën e tij i përgjigjet Kryeprokurorit të Shtetit”. Kështu kemi rëndë dakord edhe në grupin punues, edhe në Komisionin për Legjislacion, kështu që ne nuk kemi ndonjë mendim tjetër, prandaj e mbështetim propozimin e komisionit. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Zemaj, dëshiron të flasësh?

ARMEND ZEMAJ: Ne paraprakisht e bëmë anëtar Kryeprokurorin e Shtetit, e bëmë jo nga zyra e tij, dhe tash mënyrë logjike është që të mbetet ashtu siç ka qenë në projektligjin e vjetër. Fjala ka të bëjë për Kryeprokurorin, është përgjegjës për punën e tij, i përgjigjet Kryeprokurorit të Shtetit. Domethënë është mirë të mbetet që Kryeprokurori është përgjegjës për punën e Prokurorisë dhe për punën e vet i përgjigjet Kryeprokurorit të Shtetit dhe Këshillit Prokurorial, sepse ai tash është edhe anëtar aty me të drejtë vote. Kështu që është mirë, pasi atje e ndryshuam, ta ndryshojmë edhe këtu, dhe e përkrah propozimin që doli nga ministri që të mbetet siç ka qenë në formulim. Është në mënyrë precize me atë çka e rregulluam edhe më herët.

Sepse, në momentin kur e kemi eliminuar atje, atëherë përgjegjësinë është dashur ta bartim diku.

KRYESUESI: Në qoftë se mendoni që ta lëmë siç ka qenë, atëherë duhet ta heqim krejt amendamentin, të mos e votojmë fare.

Ok-ej! E hedhim në votim, i dëgjuat mendimet e dyja palëve.

E votojmë amendamentin 5, me elektronikë. Kush është për, kush është kundër? Votojmë tani!
Faleminderit!

Me 47 vota kundër, 2 abstenime dhe 21 vota për, nuk miratohet. Bie poshtë amendamenti 5.

Për amendamentin 6 janë paraqitur dy diskutues, Bojan Mitiq dhe Danush Ademi. Zoti Mitiq, e keni fjalën. Të dytë gabimisht si duket e kanë shtypur.

Amendamenti 6

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 7

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 8

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 9

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 10

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 11

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 12

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 13

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 14

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 15

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 16

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 17

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 18

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 19, i kemi dy propozime. Zonja Haxhiu e ka fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Po te amendamenti 19 i kemi dy propozime. I pari është propozimi i Komisionit Funkcional, që thotë: “Gjatë kohëzgjatjes së mandatit të EULEX-it në Kosovë, Kryeprokurori i Shtetit nuk mund t’i marrë nën juridiksion rastet që i janë caktuar një prokurori të EULEX-i pa pëlqimin e kryeprokurorit të EULEX-it”.

Dhe, propozimi im është që ky paragraf, pra përkatësisht neni 12, paragrafi 1 i projektligjit të fshihet në tërësi. Arsyeja kryesore është që nëse në tërë tekstin e projektligjit për Prokurorinë e Shtetit e kemi fuqizuar rolin e Kryeprokurorit karshi prokurorëve të tjerë, atëherë ç’kuptim ka që me këtë amendament po e degradojmë rolin e Kryeprokurorit të Shtetit, në mënyrë që kryeprokurori nuk ka të drejtë, pa një mendim të kryeprokurorit të EULEX-it, ta marrë një lëndë? Pra, konsiderojmë që kjo është e padrejtë dhe kërkoj nga deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës që të mos e përkrahin propozimin e Komisionit për Legjislacion, mirëpo propozimin tim, që është propozimi i dytë. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Zemaj, e keni fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryesues!

Edhe këtu kemi të bëjmë me qartësim, apo me formulim të saktë se çka thotë sponsorizuesi me këtë dhe çka ka dashur, se ka dashur të jetë pjesë e kësaj.

Është në dispozitat kalimtare, e vetë dispozitat kalimtare tregon që kjo është kalimtare për këtë periudhë kohore sa është mandati i EULEX-it në Kosovë.

Këtu kemi të bëjmë me lëndët, të cilat veç i ka, bile-bile para vitit të kaluar, se prej vitit të kaluar asnjë lëndë nuk mund ta marrë EULEX-si pa leje të Kryeprokurorit të Shtetit, që i bie vendor, shqiptar, apo kosovar.

Edhe mos harroni ,te amendamenti 6, që e votuam më herët, ne e kemi sanksionuar - çdo marrje e rastit duhet të bëhet me vendim të arsyetuar, bile-bile e kemi sanksionua edhe Kryeprokurorin që nuk mund ta marrë një lëndë në një prokurori themelore atje në territor të caktuar për teke të individit apo të dikujt, pa e pasur një vendim të arsyetuar. Kështu që kjo ka të bëjë vetëm për një periudhë kalimtare, për lëndët të cilat i ka në posedim, e jo për lëndët e reja dhe nuk ka diçka që e prish as strukturën, por as i cenon të drejtat dhe pavarësinë e Kryeprokurorit të Shtetit.

Kështu që ju kisha lutur që kjo të mbetet ashtu siç e ka propozua Ministria e Drejtësisë dhe nuk ka ndonjë dilemë nëse i cenon, apo nuk i cenon. Është një formulim i saktë edhe është shumë konciz në atë që i përket pëlqimit për një lëndë të caktuar. Faleminderit!

KRYESUESI: Zonja Haxhiu, edhe një herë e ka fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Unë po e lexoj propozimin, siç është i shkruar, ndoshta zoti Zemaj e ka një tekst tjetër, kush e di! Por, këtu po thotë: “Kryeprokurori i Shtetit nuk mund të marrë nën juridiksion raste që i janë caktuar një prokurori të EULEX-it”, dhe këtu nuk vlen fakti i mendimit të arsyetuar, siç e kemi

kur Kryeprokurori ua merr ndonjë rast prokurorive të tjera. Aty po. Thuhet që duhet vendimi të jetë i arsyetuar, i bazuar. Mirëpo kjo nuk vlen te rasti i EULEX-it, sepse këtu vetë e specifikon, gjatë kohëzgjatjes së mandatit të EULEX-it. Sa është ajo kohëzgjatje e mandatit, sepse për çdo vit po e vazhdoni mandatin e EULEX-it në Kosovë. Për atë arsye, unë po kërkoj edhe një herë nga deputetët që të mos e përkrahin rekomandimin e komisionit.

KRYESUESI: Faleminderit!

Atëherë e hedhim në votim amendamentin 19, propozimin e Komisionit FunkSIONAL, sipas renditjes. Votojmë me elektronikë. Votojmë tani!

Atëherë, me 50 vota për, 19 vota kundër dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti 19.

Sipas Rregullores, ne duhet ta nxjerrim në votim edhe amendamentin e zonjës Haxhiu. Votojmë me elektronikë. Votojmë tani!

43 vota kundër, 3 abstenime dhe 23 vota për, nuk miratohet.

Amendamenti 20. Zoti Kuçi e ka fjalën.

MINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Unë mendoj që amendamenti 20 nuk duhet të përkrahet. Propozimi i Ministrisë ka qenë që statusi i stafit administrativ do të rregullohet me ligj të veçantë. Ndërsa është propozuar që stafi administrativ t'i nënshtrohet parimit të shërbimit civil. E unë kam marrë kërkesë të vazhdueshme nga Administrata e Gjyqësorit dhe e Prokurorisë që t'i heqin nga shërbyesit civilë dhe unë mendoj që ne duhet ta përkrahim, ta nxjerrim një ligj të veçantë që ata do t'i trajtojmë pastaj si nëpunës shtetërorë, e jo si shërbyes civilë. Ky ka qenë qëllimi pse kemi thanë kështu. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Krejt kjo, ministër, derisa të nxirret ligji i veçantë, sepse nëse ne sot e heqim atë, me cilat parime do të zgjidhen ata. Ne kemi biseduar edhe me Këshillin Gjyqësor, edhe me Këshillin Prokuroral. Nëse ju e dini që për një periudhë shumë të shkurtër kohore nuk mund t'i nënshtrohet asnjë lloj konkursi, për një javë vjen ligji i veçantë, atëherë ne në komision jemi pajtuar që ata të rregullohen me ligj të veçantë. Por, ka mbetur që t'u nënshtrohen parimeve të shërbimit civil, ata që janë për përzgjedhje, por të rregullohen me ligj të veçantë. Dhe, Komisioni ka qenë kategorikisht që këto dy institucione apo nëpunësit e tyre ta kenë ligjin e veçantë.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kuçi, edhe një herë e ka fjalën.

MINISTRI HARJEDIN KUÇI: Faleminderit, zoti Zemaj!

Edhe pse propozim ynë nuk e përjashton këtë, se thotë statusi i stafit administrativ do të rregullohet me ligj të veçantë. Pra, nuk e përjashton. Por, ajo çka do të them, atëherë nëse pajtoheni me amendamentin tuaj duhet ta shtoni "derisa të rregullohet me ligj të veçantë". Veç ia shton fjalën "derisa". Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Është e njëjta, sepse ne e kemi miratuar edhe te Këshilli Gjyqësor, te Këshilli Prokurorial, domethënë është edhe te ligjet tjera. Tash, këtu e pamë, atëherë ose duhet ta rregullojmë në të dyja institucionet, ose vetëm këtu.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Haxhiu e ka fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Tash po i vëreni edhe problemet nëpër të cilat po kalojmë për shkak të procedimit të përshpejtuar të këtyre projektligjeve, që janë tepër të rëndësishme.

Dhjetë muaj është dashur që t'i shqyrtojë Komisioni për Legjislacion, sepse një projektligj i merr dy muaj dhe në vend se t'i kemi të paktën disa muaj, ne e kemi vetëm një javë për t'i shqyrtuar.

Ne e votuam një projektligj më përpara, është Projektligji për gjykatat. E votuam edhe amendamentin e Komisionit për Legjislacion, që është i njëjtë, sepse jemi munduar që çfarëdo amendamenti ta bëjmë që t'i harmonizojmë, edhe të Këshillit Prokurorial, edhe të Këshillit Gjyqësor, edhe Prokurorinë, edhe gjykatat, dhe ne e kemi përkrahur më përpara amendamentin që statusi i stafit administrativ u nënshtrohet parimeve të shërbimit civil dhe do të rregullohet me ligj të veçantë.

Pra, kështu e votuam më përpara, e unë po i ftoj deputetët e Kuvendit që të mbetet kështu siç e ka propozuar Komisioni për Legjislacion. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Kuçi, përsëri!

MINISTRI HAJREDIN KUÇI: Unë e kuptoj se kjo është lojë fjalësh, por mos u bëni merak, se ligjin që e sjell do të them që është ligj i veçantë dhe e ... ligjin e përgjithshëm. Lirisht miratojeni amendamentin tuaj.

KRYESUESI: Zonja Tërmkolli e ka fjalën.

MELIHATE TËRMKOLLI: Në fakt, atë çka desha ta them, më në fund veç e kuptoi ministri, e tha. Unë mendoj që këtë që e tha zoti Zemaj, duhet votuar, për faktin që ne nuk mund paraprakisht ta rregullojmë një çështje, pa e pasur ende ligjin dhe t'ia caktojmë statusin dikujt. Ne na duhet ta nxjerrim një ligj për shërbyesit, nëse e bëjmë shtetërorë, dhe tek mandej kjo të hyjë në kuadër të shërbyesve shtetërorë, jo paraprakisht me ligj të veçantë. Është një rregull e padiskutueshme ligjore. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Gashi, dëshironi të flisni?

ARBEN GASHI: Faleminderit!

Mendoj se për ta sqaruar këtë çështje, pjesa që tha zoti Kuçi qëndron. Po ashtu, nëse ka ndonjë dilemë dikush edhe interpretimi autentik, ideja, fryma, germa e Kuvendit është që vlen Ligji për shërbimin civil, derisa të vijë ligji i veçantë dhe është krejt në rregull. Kështu që të mos i krijojmë dy modele të ndryshme në dy ligje që i rregullojnë dy institucione të veçanta.

Prandaj, mendoj se duhet të shkojmë me një model dhe modeli është ai që është propozuar nga zoti Zemaj. Faleminderit!

KRYESUESI: Atëherë:

Amendamenti 20

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

E votojmë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Votojmë tash!

Konstatohet që me 56 vota për, dy abstenime dhe 19 kundër, Kuvendi e miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për prokurorin e shtetit.

8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për përgjimin e telekomunikimeve

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

E ftoj kryetaren e Komisionit Funkcional për Integritet Evropian, zonjën Sahatqija, që para deputetëve ta paraqesë dhe arsyetojë raportin me rekomandime. Zonja Sahatqija, e keni fjalën.

TUETA SAHATQIJA: Faleminderit, zoti kryesues!

Në bazë të nenit 57 dhe 69 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Komisioni për Integritet, më 22 maj 2015, e shqyrtoi dhe e amendatoi Projektligjin për përgjimin e telekomunikimeve dhe e procedon me komisionet e përhershme raportin me amendamente për vlerësimin sipas kompetencës në vijim, ku do të shqyrtohen amendamentet.

Në fakt, ky është ligj i cili për një kohë të gjatë është duke ardhur në Kuvendin e Kosovës dhe besoj që sot do të kalojë.

Kur të vijmë te disa amendamente, do të ndalem që në mënyrë të veçantë të shpjegoj se ky ligj i ka edhe dy amendamente prej dy deputetëve dhe në disa amendamente do të ndalem dhe do ta kërkoj fjalën për sqarim. Mund të procedojmë me amendamente. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pra, projektligji i ka 22 amendamente, për amendamentin e pestë janë dhënë tri propozime: a.) propozimi i Komisionit Funkcional, b.) propozimi i deputetit Nait Hasani, pa përkrahjen e Komisionit Funkcional dhe c.) propozimi i deputetit Bekim Haxhiu, pa përkrahjen e Komisionit Funkcional.

Vazhdojmë me votimin e amendamenteve.

Amendamenti 1

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 2

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 3

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 4

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 5. Janë tri propozime, në qoftë se dëshiron dikush nga propozuesit që të flasë lidhur me këtë amendamentet e tyre, ose lidhur me amendamentin e pestë. Fjalën e keni të gjithë. Fillimisht, zonja Sahatqija!

TEUTA SAHATQIJA: Le të jetë propozuesi fillimisht, pastaj e marr unë fjalën.

KRYESUESI: Zoti Nait Hasani e ka fjalën.

NAIT HASANI: Faleminderit, nënkryetar!

Përshëndetje për ministra,

Në nenin 5 kemi bërë amendament, te përgjimet e telekomunikimeve, në pikën 1.2 për nevojat e strukturave të inteligjencës dhe sigurisë kombëtare.

Në amendament kemi kërkuar që përgjimi të bëhet për nevojat e sigurisë kombëtare, prandaj kemi kërkuar të hiqet “strukturat e inteligjencës”, sepse ka mundësi të ndodhin keqpërdorime të ndryshme, e për t’u ikur këtyre keqpërdorimeve është kërkuar që të jetë “për nevojat kombëtare, apo shtetërore”. Prandaj, unë kam propozuar amendament dhe komisioni e ka pranuar. Faleminderit!

KRYESUESI: Jo, është pa përkrahjen e komisionit, është mendim yti. Komisioni s’mund të ta ndalojë amendamentin.

Amendamenti i deputetit Bekim Haxhiu, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Realisht, po e trajtojmë një prej projektligjeve, të cilin më herët dy herë e kemi kthyer. Kemi pasur shumë mundësi që edhe në ato periudha kohore, kur këtë projektligj e kemi kthyer, që në komisione të punohet gradualisht dhe të punohet pa nguti, që vërtet të nxjerrim ligje sa më të mira dhe në interes të qytetarëve.

I kam lexuar edhe amendamentet tjera të komisionit. Edhe pse ky projektligj do të duhej të bashkërendohej në shqyrtim me Komisionin për Siguri dhe Komisionin për Inteligjencë, tani është trajtuar në Komisionin për Integritet Evropian, që nuk kam asgjë kundër komisionit, mirëpo në aspektin procedural shpeshherë po ndodh që ne deputetët kur bëjmë amendamente nuk ftohemi në komision për ta arsyetuar dhe për t’i mbrojtur amendamentet tona. Mirëpo, këto amendamente komisionet shpeshherë dhe në shumicën e rasteve i trajtojnë pa qenë fare ne aty.

Kërkoj nga Sekretaria e Kuvendit, që e organizon punën e komisioneve, që të jetë më e përgjegjshme në këtë drejtim dhe kur të ketë amendamente të deputetëve të na njoftojnë për takimin kur do të trajtohen projektligjet edhe ne t'i arsyetojmë amendamentet tona.

Amendamenti im ka qenë në kuptimin e asaj që të mundësohet që Agjencia e Inteligjencës që t'i bëjë përgjimet për nevojat e sigurisë kombëtare. Unë mendoj që është e nevojshme që Agjencia e Inteligjencës konform ligjit dhe procedurave të parapara ta bëjë një gjë të tillë - përgjimet për nevojat e sigurisë kombëtare, për arsye se edhe intenca e krijimit të kësaj agjencie është siguria e përgjithshme kombëtare apo shtetërore, sido që ta quajmë.

Edhe një çështje tjetër, derisa i kam shqyrtuar këto amendamente, që mbetet ta them, çdonjëri prej qytetarëve të Republikës së Kosovës e ka atë ndjenjën se se dikush përgjon, ose është i përgjuar.

Edhe për amendamentet të cilat po i propozojmë në seancë nuk po trajtohen nga Sekretaria. Sigurisht që është e nevojshme që ne edhe nga një herë t'i bëjmë, mirëpo në bazë të Rregullores së Kuvendit kur ato amendamente bëhen në seancë, në nene të caktuara, mendoj që ato duhet të protokollohen dhe të trajtohen nga komisionet përkatëse parlamentare.

Për ta evituar mentalitetin e krijuar, apo logjikën e krijuar që çdokush po përgjon dhe çdo duksh është i përgjuar, kam kërkuar që pjesët e këtij projektligji vërtet të rregullohen me një amendamentet, kur pas çdo përgjimeve - përfundimit të përgjimeve dhe kur nuk ka ndjekje të mëtutjeshme penale pas tre ose pesë vjetëve qytetarët të njofton për arsyen pse kanë qenë të përgjuar.

Kjo do ta hiqte atë batutën, e cila është krijuar deri tash dhe vërtet është edhe në interesin e transparencës, por edhe në interesin e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut, që çdokush që ka përgjuar dhe ka rezultuar që ka qenë ose padrejtësisht i përgjuar, ose në emër të diçkaje tjetër, të jetë i njoftuar për atë procedurë. Shumë vende tjera e kanë të rregulluar në këtë formë dhe mendoj se do të duhej edhe ne ta kemi.

Mirëpo, për shkak që është dashur që tani ta kalojmë këtë projektligj në procedurë të shpejtë, le të kalojë kështu si ka kaluar, me kusht që të kalojë vërtet në kuptimin jo të kushtëzimit, por që edhe me amendamente e propozuara nga ne të trajtohet në mënyrë serioze. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Unë mendoj që ligji është kthyer që të mos ketë hapësirë që të shkelen të drejtat e njeriut dhe është bërë mirë që është kthyer. Nuk ka shërbim informativ kombëtar që ai konstaton se cila është siguria kombëtare - është ligji, është e drejta e prokurorit dhe është e drejta e çdo shërbimi dhe çdo institucioni që të kërkojë nga Kryeprokurori për t'u përgjuar kushdo. Në qoftë se ne e lëmë në duart e shërbimit, unë po ju them që, s'po dua të flas, por unë e di çfarë kanë bërë shërbimi dhe si ka vepruar, dhe mendoj që jashtë ligjit, jashtë kompetencave të Prokurorit të Përgjithshëm nuk duhet t'ia lëmë askujt. Kryeprokurorit mund t'i drejtohem edhe ne deputetët me informata, me kërkesa, le ta konstatojnë qysh e ka krejt bota. Ndërsa ajo pas pesë vjetësh, unë jam kategorikisht kundër që t'i jepen pas pesë vjetësh, sepse kushdo që përgjohet duhet të jepen letrat, t'i thuhet 'a ke përgjuar', 'të kemi përgjuar', 's'ke asgjë', a dëshiron ta asgjësosh vetë, apo po e asgjësojmë ne.

Kjo duhet të jetë qysh funksionon në Evropë, në qoftë se ne duam t'i ruajmë 50 vjet përgjimet, e pas 50 vjetëve, duke e quajtur njeriun “kriminel, hajdut, antikombëtar, spiun”, atë herë t'i themi “këqyre, të kemi quajtur 50 vjet spiun, edhe hajdut, edhe kriminel” dhe po ta japim tash këtë e shikojë në shtëpi. Kjo nuk është në rregull. Pra, nuk është në rregull!

Pra, unë mendoj që është bërë mirë që ka mbetur në duart e prokurorit dhe në qoftë se duhet me nxjerrë ndonjë ligj të veçantë për komunitetin apo Këshillin e Sigurisë Kombëtare dhe ata mund ta marrin ndonjë vendim të veçantë, atëherë ta shohim edhe atë ligj ta shqyrtojmë.

Zonja Teuta Sahatqija e ka fjalën lidhur me këtë.

TEUTA SAHATQIJA: faleminderit, zoti kryesues!

Më duket që u hap debati për ligjin, po prej diskutimeve më tepër debati ishte për ligjin e kaluar sesa për këtë ligj. Shumica e gjërave të cilat u cekën gjatë këtij debati janë të tejkaluara dhe ne në komision i kemi eliminuar.

Nuk ekziston mundësia që të ruhen pa e njoftuar personin, i cili është përgjuar edhe nuk ka asnjë shans që ato të ruhen, jo 5 vjet, por asnjë vit. Prandaj, mendoj që biseda devijoi totalisht. Por, të kthehemi në amendament nën 1, unë i falënderoj të dy deputetët, të cilët i kanë sjellë amendamentet. Amendamentet të cilat i kanë sjellë janë plotësisht në akordancë me amendamentin, të cilin e kemi punuar në Komisionin e Integritetit. Në anën tjetër, mbledhjet e secilit komision janë mbledhje publike, janë mbledhje që janë në ueb-faqen e Kuvendit të Kosovës dhe ne nuk kemi mbajtur mbledhje të fshehura, që nuk ka pasur mundësi të vijë kushdo.

Ndoshta kemi gabuar që nuk kemi dërguar ftesa speciale, por dëshiroj për hir të opinionit të dihet që çdo mbledhje ka qenë publike, ka qenë e përcjellë nga një numër i madh i medieve. Më lejoni të shpjegoj pse nuk e kanë marrë këto dy amendamente përkrahjen e komisionit. Në të dyja amendamentet përmendet përgjimi për nevojat e sigurisë kombëtare. Nga ekspertët me të cilët kemi komunikuar thanë që nocioni “siguria kombëtare” nuk ekziston, por ekziston nocioni “siguria e Republikës së Kosovës”.

Prandaj, termi “siguria kombëtare” nuk pati mundësi që të aprovohet si amendament. Në amendamentin e bërë nga zoti Bekim Haxhiu thuhet që përgjimi bëhet nga strukturat e inteligjencës për nevojat e sigurisë kombëtare. Ne i kemi hequr fare strukturat e inteligjencës dhe amendamenti i komisionit është përgjimi për nevojat e sigurisë të Republikës së Kosovës.

Mendoj që atë që e kanë kërkuar edhe dy deputetët, edhe në komision është plotësuar plotësisht, domethënë është në amendamentin, të cilin e ka propozuar komisioni. Prandaj, unë propozoj në emër të komisionit që këto dy amendamente të mos votohen po të votohet amendamenti i Komisionit për Integritet Evropian pasi ideja për të cilin janë bë amendamentet është plotësisht brenda amendamentit të komisionit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Edhe një herë desha të sqaroj sa i përket pjesëmarrjes së deputetëve në mbledhjet e komisioneve: Deputetët mund të marrin pjesë në secilin komision në mbledhjet e tyre dhe mund të diskutojmë. Tjetër gjë është që në disa komisione ose në ato komisione që s'janë anëtarë, s'kanë të drejtë vote, por për të diskutuar, për të biseduar rreth çështjeve që u

intereson, është e drejtë e tyre dhe askush s'mund t'i ndalojë. Ndoshta ka çalim te njoftimi që po thuhet dhe ne mund të kërkojmë që çdo javë të jepet agjenda kur komisionet kanë mbledhje dhe cilat ligje shqyrtohen, përndryshe s'e di.

Fjalën e ka kërkuar zoti Hamiti.

SABRI HAMITI: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Një ligj tepër i ndjeshëm që ka dy etapa historie në Kuvendin e Republikës së Kosovës, një herë i refuzuar gati në mënyrë konsensuale dhe herën e dytë i pranuar gati në mënyrë konsesuale.

Këtu jemi strikt dhe saktë në një moment të ndjeshëm, ku dalin problemet themelore për çka edhe refuzohej njëherë dhe pranohej herën tjetër. Por, edhe kjo pikë na del me tri variante, një të Komisionit FunkSIONAL dhe dy të deputetëve. Çështja është se kur flitet për përgjimet, zakonisht shtrohet pyetja kush përgjon, tani pse përgjon dhe për çka përgjon?

Unë po e thjeshtoj problemin, por esenca janë këto dhe kur thyhen këto përgjigje, këto tri pyetje, atëherë domosdoshmërisht hyjmë në fazën e diskutimit rreth lirive të individit dhe privatësisë së tij dhe rreth asaj që quhet "siguri kolektive". Dikush po e thotë "kombëtare", dikush "shtetërore", por formulimet pak a shumë janë variante të formulimeve për një substancë.

Unë, meqë jemi në fazën finale të votimit, do ta propozoja një variant të vogël, duke e pasur parasysh këtë problemin e sigurisë kolektive, por edhe ruajtjes të asaj që quhet privatësi ose liri individuale, që formulimi të jetë për nevojat e sigurisë së qytetarëve, ose nëse doni - të popullit, si të keni qejf, edhe të Republikës së Kosovës. Pse? E shoh të arsyeshme që të bëhet ky formulim, jo vetëm të Republikës së Kosovës, pikërisht duke pasur parasysh këtë lojë të përhershme të kombinimit se çka bëhet për sigurinë kolektive dhe çka bëhet për ruajtjen e lirisë individuale.

Pra, unë propozoj për "nevojat e sigurisë së qytetarëve të Republikës së Kosovës" t'i mbrojnë njerëzit dhe sistemin, por jo vetëm sistemin. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Gashi e ka fjalën.

ARBEN GASHI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Çështjet që po debatohen këtu janë goxha komplekse dhe është e vërtetë që debati fillon qysh në nivelin e sigurisë së përgjithshme dhe personale, dhe lirisë individuale e kolektive, dhe këto debate nuk bëhen vetëm sot në Kosovë, por bëhen në të gjitha vendet moderne, dhe mendoj se janë edhe problematike.

Le të kthehemi te kompetenca e komisionit. Cili është komisioni kompetent për ta trajtuar këtë çështje, është çështje që po ashtu në vazhdimësi është trajtuar me shqetësim dhe të dy jakomisionet që pretendojnë që janë më profesionale, si Komisioni për Mbikëqyrjen e Agjencisë Kosovare të Inteligjencës dhe Komisioni për Siguri e Punë të Brendshme, si duket, është vlerësuar që kanë tepër kompetenca dhe ndoshta të mos përfshihen shumë bëhet problem.

Mendoj se te amendamenti 5 problemi është kufizues, çështja është kufizuese dhe mendoj që është problematik në vetvete përgjimi për nevojat e sigurisë së Republikës së Kosovës. Unë jam i bindur se nuk bëhen vetëm përgjime për nevojat e sigurisë së Republikës së Kosovës, por edhe të vendeve partnere, të shteteve partnere. Kur anëtarësohesh në organizata ndërkombëtare, ti këto shërbime do t'i ofrosh edhe për të tjerët, e ky ligj e kufizon vetëm për nevojat e sigurisë së Republikës së Kosovës, kështu që terminologjia që përdoret këtu apo tjetra për nevojat e sigurisë kombëtare - ti bën përgjime edhe për nevojat e sigurisë ndërkombëtare, kështu që këto elemente duhet pasur në konsideratë dhe të mos jemi kufizues në mundësinë që t'i japim shërbimet për t'i kryer detyrat e veta, por në të njëjtën kohë të mos japim tepër përgjegjësi, sepse mund të shndërrohet në rrezik për qytetarët e Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Është vetëkuptueshme që shërbimet kanë partnerët e tyre që bashkëpunojnë. Zoti Ibishi e ka fjalën.

NUREDIN IBISHI: I nderuar zoti kryesues!

Pa dashur të marrë shumë koha, pasi zoti Gashi e ceku aspektin e mbikëqyrjes funksionale nga të dyja komisionet, domethënë për mbikëqyrjen e sektorit të sigurisë dhe është e paakceptueshme edhe për mua, edhe për anëtarët e dy komisioneve, sesi Komisioni për Integritet e merr një rol të mbikëqyrjes kur ai është komision i përhershëm. Mendoj që në këtë aspekt, ndoshta edhe për ne është mundësia, edhe e këtij Kuvendi, meqë Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione nuk është komision i përhershëm që e prek thellë aspektin edhe të të drejtave të njeriut, sidomos te privatësia. Sido që të jetë, tash nuk mund ta ekzagjerojmë temën, por unë po lidhem në aspektin se nesër, nëse trajtohet një çështje që ka të bëjë me agjencitë që janë kompetente për zbatimin e kësaj, siç është Policia e Kosovës, Inspektorati Policor i Kosovës e Agjencia për Inteligjencë e Kosovës...

KRYESUESI: Të lutem, rreth amendamenteve, mos u fut në histori! Ka mbaruar historia!

NUREDIN IBISHI: ...jo! Ka mbaruar, por unë vetëm po flas nga aspekti, pasi këtë çështje e kam parashtruar herën e kaluar pse komisionet funksionale nuk e marrin mandatin. Unë nuk e di as vetë kush e ka parashtruar që Komisioni për Integritet, kur është komision i përhershëm, ta marrë rolin e komisioneve funksionale që ta mbikëqyrë sektorin e sigurisë. Kjo është e tëra.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Haxhiu prapë e ka kërkuar fjalën.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

U tha edhe sa i përket shqyrtimit, nuk dua të hap debat për atë, mirëpo termet dhe terminologjitë në se duhet të jetë “kombëtar” apo “shtetëror”, kjo terminologji është përdorur edhe në draftin e parë, kështu që nuk është ndonjë çështje ajo se si, por është me rëndësi që ne si deputetë mendojmë që me këto amendamente ta japim kontributin tonë në trajtimin e ligjeve, t'i pasurojmë ligjet dhe nëse jemi edhe pjesë e diskutimeve mendoj që mund t'i pasurojmë këto diskutime, të cilat janë publike, edhe pse nganjëherë mungojnë ndoshta njoftimet adekuate. Dhe duhet të flas, i nderuar kryesues, nuk e thashë 50 vjet, por thashë 5 deri në 10 vjet. Domethënë kur duhet të njoftohet, se më duket e ke keqkuptuar.

Prandaj, mendova që njoftimi për qytetarët kur kanë qenë të përgjuar do të ishte duhej paraparë me ligj për shkak të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të tyre dhe privatësisë së tyre që të njoftohen së paku pas 5 ose 10 vjetëve se kanë qenë të përgjuar. Faleminderit!

KRYESUESI: Unë e di që ka një ligj për ruajtjen e dokumenteve të klasifikuara në të, por përgjimi është pak i ndjeshëm, sepse pastaj e dini çfarë na ka ndodhur me këto përgjime, të mos të flasim. Zoti Haradinaj e ka fjalën.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, kryesues!

Është e vërtetë që mirë është për herë të parë është një ligj, edhe pse, çuditërisht, ky ligj është hequr prej Komisionit të Sigurisë, domethënë nuk është faji ynë, por kështu kanë vendosur, i janë drejtuar Komisionit për Integritet.

Në bazë të këtij ligji shihen tri gjëra që mungojnë. E para, mungon ndëshkimi për operatorët në rast se e shkelin ligjin, domethënë operatorët nuk ndëshkohen në rast se e shkelin ligjin. E dyta, mungon zyra e ankesave, po që se qytetarit të Kosovës i është shkelur e drejta. Domethënë nuk ka zyrë të ankesave, ligji nuk e parasheh. Në rast se janë shkelur të drejtat, operatori nuk ka të drejtë të penalizohet. Dhe, ç'është më kryesorja, përgjimet nuk i mbikëqyr asnjë organ kompetent. Do të thotë, nuk ka adresë mbikëqyrëse. Unë mendoj që duhet të jetë organi kompetent mbikëqyrës i operatorëve dhe mbi këtë ligj nuk ka as për së afërmi harmonizim.

Të paktën, domethënë mbikëqyrje parlamentare duhet të ketë dhe këto janë standarde të BE-së. Ne kemi marrë edhe rekomandime prej shumë organizatave që ta kemi parasysh mbikëqyrjen parlamentare të përgjimeve, të ruajtjes së fshehtësisë, garantimin e përgjimeve, mbikëqyrjen e eliminimit të provave nga uni i prokurorit ose nga vetë prokurori. Domethënë me këtë ligj asnjë prej këtyre nuk parashihet. Kaq kisha. Domethënë, unë mendoj që është ligj i cekët.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Pajaziti e ka fjalën.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë mendoj që në lexim të dytë është rendi t'i aprovojmë amendamentet që janë këtu. Kemi pasur goxha kohë, ka pasur edhe debate, ka qenë mirë që edhe Komisioni për Siguri ta bëjë një amendament, meqenëse është fushë goxha e dedikuar. Ka qenë gabim që Komisioni i Integritetit e ka trajtuar, ndërsa unë vetëm dëshiroj t'ju them që debati ndërmjet asaj nëse jemi duke u marrë më shumë me privatësinë, apo me sigurinë, duhet ditur që ky projektligj i dedikohet nevojës të madhe të këtij vendi për t'i luftuar dukuritë e këqija dhe i dedikohet spekitrit të sundimit të ligjit. Nëse ne e kemi prioritet në këtë vend që disa vite në Raportin e Progresit të merremi marrë më shumë me sundimin e ligjit, duhet dhënë dritën jeshile në mënyrë që institucionet përkatëse të kenë më shumë mundësi në përmjet këtij ligji t'i luftojnë këto dukuri dhe duhet pasur më shumë besim.

Unë i kuptoj shqetësimet për privatësinë, por kemi ligje tjera me të cilat mund ta ruajmë atë, të kujdesemi më shumë për të dhënat, për privatësinë etj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Unë ju lus, meqë e kemi në shqyrtim amendamentin e pestë, nuk kemi të bëjmë me histori. Zonja Sahatqija, si kryetare e komisionit, e ka fjalën.

TEUTA SAHATQIJA: Zoti kryesues!

Ia nisëm të bisedojmë për ligjin, thuajse është në lexim të parë, gjë që nuk është në rregull. Ky është ligj që me vite është nëpër Kuvend.

Nën një , nuk qëndron fakti që operatorët nuk ndëshkohen. Operatorët ndëshkohen deri te marrja e licencës, domethënë mënyra e ndëshkimit të operatorit është shumë e rëndë. E dyta, nuk ka ankesa. Ky nuk është i vetmi ligj, i cili e rregullon, se në qoftë se ka ankesa ekziston Kodi Penal, ekzistojnë ligjet tjera, të cilët plotësisht e mbulojnë këtë hapësirë. Dhe, e dyta, nuk ekziston mbikëqyrja parlamentare, në fakt ekziston mbikëqyrja parlamentare, përveç që nuk vjen në Parlament për të treguar a është përgjuar Teuta, a është përgjuar Hasani apo Hyseni, por tregohet me numra, me data, me shifra, pa i përmendur emrat dhe të tjerat.

Prandaj, mendoj që ky ligj, pas shumë vjetëve, ka ardhur në kohë, është analizuar, është përmirësuar dhe ka ardhur këtu. Pse është në Integritet, atë e dinë të tjerët, sepse ka qenë edhe në komisionet tjera, e për çfarë arsye ka ardhur në Integritet nuk e di dhe, fundi i fundit, as nuk është koha, as nuk është vendi tash të diskutohet kjo. Secili komision, secili deputet ka mundur t'i sjellë amendamentet të cilat nuk e kanë bërë . Prandaj, mendoj që ne tash duhet të procedojmë me atë nëse do të votohen amendamentet e deputetëve, e mendoj që për arsyet të cilat i ceka nuk do të duhej të votoheshin. Në anën tjetër, mendoj që amendamenti i komisionit, i cili thotë “përgjimi për nevojat e sigurisë së Republikës së Kosovës”, mendoj që nuk prish asgjë, përkundrazi e plotëson, e pasuron, në qoftë se shtohet “përgjimi për nevojat e sigurisë së qytetarëve dhe Republikës së Kosovës”.

Mendoj që këtë duhet ta hidhni në votim.

KRYESUESI: Faleminderit! Unë mendoj është hapur lista e diskutuesve, e unë ua jap fjalën vetëm propozuesve dhe deputetët mund t'i japin mendimet e tyre me votë. Janë tri amendamente, në qoftë se duam të hapim debat për këto amendamente të propozuara. shikoni në rrethanat në të cilat jemi ne në Kosovë, në qoftë se bëjmë “kombëtar”, atëherë duhet bërë “kombëtare - ndërkombëtare”, dhe nëse e bëjmë kombin kosovar, siç po duan disa, atëherë e bëjmë.

Zoti Nait Hasani e ka fjalën, meqenëse e ka një amendament propozuar.

NAIT HASANI: Faleminderit!

Edhe njëherë në projektligj ka ardhur “përgjimet për nevojat të strukturave të inteligjencës dhe sigurisë kombëtare”. Nuk kemi dashur ta marrim çështjen “kombëtare” që ta diskutojmë.

Karakteri kombëtar varet nga shteti, e kemi shtetin kombëtar apo nuk e kemi shtetin kombëtar. E kemi shtetin e qytetarëve, prandaj edhe nuk kam dashur ta përziej këtë çështje. Mua më ka interesuar çështja e strukturave të inteligjencës, për nevojat e tyre duhet të përgjohen, apo jo. Përgjimi për nevojat e strukturave të inteligjencës është forma kriminale që mund t'u bëhet qytetarëve. Prandaj, kjo ka qenë kërkesa ime e heqjes, a t'ia shtojmë ne Republika e Kosovës a jo, ky ligj bëhet për Republikën e Kosovës, për Kosovën. Nuk bëhet për Belgjikën, as për Maqedoninë.

Prandaj, për nevojat shtetërore jemi të pajtimit që të jetë “përgjimi për nevojat e sigurisë shtetërore”, kuptohet që është për çështjen e Kosovës, nuk është për çështjet e jashtme. Faleminderit!

KRYESUESI: Shikoni, këtu janë paraqitur tash edhe 7 diskutues. Unë mendoj që mendimet u shteruan. Një mendim konkret e ka dhënë zoti Hamiti për ta shtuar termin “për nevojat e sigurisë së qytetarëve”. Po çfarë ke të sqarosh, o burrë, e ke sqaruar në komision? Ne të gjithë të sqaruar jemi. Është një amendament që po duam ta votojmë. Fol, Ilir, ja ta jap fjalën për të na sqaruar edhe ti dhe kryhet.

ILIR DEDA: Po, nuk është puna e kryerjes. Faleminderit!

Nejse, pikë së pari, kolegë të nderuar dhe anëtarët e Komisionit për Siguri dhe për AKI, kanë qenë të ftuar për të marrë pjesë në amendamentimin e ligjit, por asnjë s’ka ardhur.

E dyta, është e vërtetë, përgjimi për nevojat e sigurisë së Republikës së Kosovës është i bazuar në ligj. Kosova ka ligj për sigurinë e vet, edhe në Kodin Penal, edhe në Ligjin për AKI-në. Ne nuk kemi terminologji të tillë, e cila thotë “siguri kombëtare”. Nuk ekziston në legjislacionin tonë dhe ne nuk mund që në konsultim me ligjet tona dhe me një grup të gjerë të ekspertëve, dhe unanimisht komisioni e ka aprovuar këtë, Arben, që neni 5 të riformulohet dhe të jetë “përgjimi për nevojat e sigurisë së Republikës së Kosovës”. Kaq! Përndryshe, ne dalim jashtë ligjeve dhe ka mundësi për keqpërdorim.

Formulimi i komisionit i shmang keqpërdorimet e mundshme aq sa mund t’i shmanget me një ligj. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z.Slobodan Petroviq.)

KRYESUESI: Zahvaljujem svima! Ima još šest prijavljenih, pitam hoćemo da idemo na debatu, ili ćemo na glasanje?

FATON TOPALLI: Faleminderit!

U dëgjuan shumë diskutime për sigurinë nacionale, për sigurinë kombëtare e kështu me radhë. Unë dua të them vetëm këtë që kushti elementar që ky ligj të funksionojë dhe të implementohet në praktikë mungon.

Pra, mungon Kodi shtetëror i telefonisë dhe Kodi shtetëror i internetit. Aktualisht, në vendin tonë, me licencë të lëshuar nga Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike veprojnë 100 operatorë që ofrojnë shërbime të ndryshme të telekomunikacionit, tre prej tyre sjellin shërbime fikse telefonike, 4 shërbime mobile, 49 shërbime interneti, e kështu me radhë. Shërbimet e licencuara, edhe pse veprojnë në Kosovë, në kontekst të projektligjit për përgjimet, në fakt, nuk janë të Kosovës, por ato kontrollohen pjesërisht, për të mos thënë plotësisht, nga shtetet e tjera.

Pra, për çfarë sigurie po flasim ne këtu, për çfarë ligji po flasim ne këtu, kur s’i kemi krijuar kushtet elementare që një ligj i tillë të funksionojë. Pra, ne po luajmë me sigurinë kombëtare, po krijojmë ligje të cilat janë të paimplementueshme në praktikë.

KRYESUESI: Zahvaljujem! Ja vas pitam, oćemo da debatujemo, ili da glasamo, a vi ste rekli da debatujemo. Idemo dalje.

Reć ima narodni poslanik, Daut Haradinaj.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit!

Unë e preka sustën më herët që t'i referohem Zenunit kur tha që përgjimet kanë ndodh urtash e 15 vjet, por ky ligj e rregullon formën e përgjimit. Edhe ne në seancën e kaluar, kur kemi folur për raportin e ruajtjeve të të dhënave civile, kemi pasur raste kur është abuzuar, edhe është shkelur ligji, edhe nuk janë sanksionuar, nuk janë marrë masat, e unë nuk e di pse Teuta po e personalizon. Kaq, s'pata më shumë.

(Drejtimitin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Nejse, tash veç mos ta humbim arsyen për atë që filluam dhe ta përfundojmë këtë amendament. Unë mendoj që të tri propozimet e kanë arsyen e vet, te nocioni kombëtar, qoftë ajo i Republikës së Kosovës, por mbi të gjitha po flasim për mbrojtjen e interesave të qytetarëve.

Ne kemi shembuj të këqij dhe kemi shembuj të mirë, sepse nëse pak thirrmi në atë në se ia marrim licencën atij, punë e madhe se ia merr licencën kur ai të përgjon ty 5-10 vjet dhe bën çfarë të dojë me ato përgjime. E keni rastin e komshinjve këtu, që po e thonë sa milionë kushtojnë ato, çka bëhet! Ne na është vjedhur Dhoma e Dëshmive midis Prishtine dhe ende askush s'ka dhënë përgjegjësi, e le më për atë se ku i çon përgjimet. Andaj, të jemi të kujdesshëm. Nuk kemi nevojë të ngutemi dhe është mirë, qoftë te nocioni për mbrojtjen e interesave të qytetarëve, të ndalemi dhe ta gjejmë solucionin më të mirë.

Nuk jemi kah shtyhem këtu ndërmjet veti se kush po ia qëllon formulimit më të mirë, por për atë çfarë dëshirojmë të arrijmë me këtë projektligj. Po shihet qartë që gabimi është bërë, të dyja komisionet është dashur të jenë ato funksionale, e jo Komisioni për Integritet Evropian. Edhe kjo është e padrejtë, duke filluar prej Kryesisë së Kuvendit që ka lejuar që ky projektligj të jetë në Komisionin për Integritet Evropian. Është dashur t'i takojë Komisionit për Siguri, nëse i besojnë, nëse s'i besojnë le të deklarojnë, të thonë nuk i besojmë këtij komisioni, as këtij komisioni.

KRYESUESI: Veç diçka! Nuk e ka ndarë Kryesia, por propozim-ligji ka ardhur nga Ministria për Integritet Evropian. Nuk ka ardhur as nga Ministria e Brendshme, as nga ndonjë ministri, as nga FSK-ja.

Tani ligji është bërë, është kthyer, plani i punës ia ka dhënë këtij komisioni të drejtë për të bërë amendamente edhe të gjitha komisioneve, edhe kanë ata të drejtë unë s'po di pse po shtroni çështje që për sot nuk janë. Zoti Çelaj e ka fjalën.

RAIF QELA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Amendamenti i pestë, i propozuar prej komisionit, e përfshin çështjen për të cilën ka dashur të plotësohet ky projektligj.

Prandaj, mendoj se ai amendament është i qëlluari, me plotësimin që ia bëri deputeti Hamiti në atë mënyrë që edhe me shpjegimet që i dha e qartësoi edhe më shumë se duhet të ketë rëndësi ajo edhe për qytetarët, të jetë përgjimi edhe për nevojat e qytetarëve.

Ky propozim i plotësuar nga profesor Hamiti u përkrah edhe nga deputetja Sahatqija dhe mendoj me të drejtë se formulimi më i drejtë është që të jetë “përgjimi për nevojat e sigurisë së Republikës së Kosovës dhe qytetarëve të saj”, sepse ky formulim është me përmbajtjen që e thanë që të dy parafolësit dhe i përfshin që të dyja çështjet dhe është edhe renditja më e mirë e fjalisë, sepse po të futet “qytetarëve të saj” përpara atëherë humb rrjedha e fjalisë.

Pra, “përgjimi për nevojat e sigurisë së Republikës së Kosovës dhe të qytetarëve të saj”. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Sabri Hamiti e ka kërkuar fjalën.

SABRI HAMITI: Faleminderit zoti nënkryetar i Kuvendit të Republikës!

U diskutua këtu në se është vonë sot të bisedojmë, çdo ligj deri në momentin kur aprovohet s’është vonë të bisedohet. Kjo përbërje e Kuvendit është ajo që e voton në finale ligjin.

Çdo ligj deri në momentin e fundit mund të mos votohet. Pra, nuk ka objektiv, nuk ka të drejtë kurrkush të thotë pse sot po bisedojmë. Nëse kjo seancë mendon se duhet të bisedohet gjatë për një pikë, për një fjalë, bisedojmë gjatë. Nëse kjo është në të mirë të ligjit. Tash po dalim në këtë që e propozova. Unë i falënderoj dy deputetët që e kuptuan thellë, vërtet thellë dhe saktë atë pse unë reagoja dhe e plotësova një formulim, i cili në të vërtetë është formulim i komisionit. E plotësova me një nuancë, e cila ka shumë domethënie. Duket që është rimarrje, por nuanca i jep kuptimin, e mbulon një kuptim më shumë.

Unë e thashë, tjetër është mbrojtja e shtetit, tjetër është mbrojtja e qytetarëve. Nganjëherë duket që janë e njëjta gjë, por nuk janë dhe kini kujdes, empiria te ne dhe në rrethinën tonë, e përtej rrethinës sonë, thotë që këto shërbime që janë ndërtuar dhe këto teknika të përcjellësve të njerëzve, të individëve, të grupeve që janë sofistikuar me emër të mbrojtjes, tashmë të republikave, nuk po ju them më shtete, por edhe emra republika, kanë degjeneruar, kanë prodhuar diktaturë. Pikë! Nuk shkoj asnjë hap më andej. Ne po duam të ndërtojmë demokraci, republikë, demokracia t’i ketë qytetarët e lirë. Prandaj, e propozova atë për plotësim, që ka shumë kuptim, dhe unë ju falënderoj të dyve që më përkrahën.

Besoj që ai veç e plotëson. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Bekim Haxhiu, me propozim konkret.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Duke u nisur me parimet dhe me bazën e propozimit të amendamentit që vërtet të bëjmë ligje sa më të mira, mendoj që edhe diskutimi i profesor Hamitit, por edhe i deputetit Raif Qela, realisht

te ky amendament po nxirret një formulim i mirë, i qëlluar. Për këtë arsye unë e tërheq amendamentin, të cilin e kam bërë dhe i mbështes propozimet, në veçanti për arsye se formulimin të cilin e bëri deputeti Raif Qela është më i drejtë dhe më i qëlluar.

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka tjerë të paraqitur. Atëherë e hedh në votim amendamentin e pestë me elektronikë, që është i propozuar nga Komisioni FunkSIONAL me propozimin shtesë për ta shtuar atë “të qytetarëve” dhe “mbrojtjen e qytetarëve”.

Votojmë me elektronikë. Votojmë tash!

Regjia, bjeri ziles një herë! Edhe një herë e përsëritim votimin. E votojmë edhe një herë amendamentin e pestë të Komisionit FunkSIONAL. Votojmë tash!

Me 59 vota për, 2 vota kundër dhe 1 abstenim, miratohet amendamenti i pestë i Komisionit FunkSIONAL.

Besoj që s’ka nevojë që amendamentet tjera t’i hedhim në votim.

Amendamenti 6

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamentin 7

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamentin 8

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamentin 9

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamentin 10

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamentin 11

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamentin 12

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamentin 13

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamentin 14

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamentin 15

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamentin 16. Zonja Sahatqija e ka fjalën!

TEUTA SAHATIQJA: Faleminderit, kryesues!

Desha një sqarim të amendamenti 16, në fakt është neni 30, pika 2, ku komisioni kërkoi që ruajtja e metadatave, do të thotë jo e materialit të përgjimit, por metadatat janë numri i telefonit, prej kur është thirrur, prej çfarë kohe, prej cilit aparat është bërë thirrja etj.

Duke mos e përfshirë substancën e përgjimit në versionin paraprak, ka qenë që operatori duhet t'i ruajë për 12 muaj, ne i kemi shkurtuar dhe kemi thënë që maksimalisht këto metadata mund të ruhen për 9 muaj. Në fakt, kemi pas reagime prej Shoqërisë Civile, edhe këtu, edhe në Kosovë, edhe një organizatë e jashtme, e cila propozoi që formulimi të jetë jo më tepër seç që është e nevojshme. Unë mendoj dhe në komision e kemi analizuar bukur shumë që maksimalisht 9 muaj është më e përshtatshme sesa aq sa nevojitet, sepse fjala "aq sa nevojitet" mund të jetë prej 1 deri në 50 vjet, do të thotë nuk e përcakton një afat kohor.

Prandaj, vetëm për hir të sqarimit, nuk kemi të bëjmë me materialin e përgjuar, por kemi të bëjmë me metadata. Përndryshe, operatorët telefonikë, në fakt, edhe i ruajnë për nevojat e tyre, edhe pas një viti mund të shkosh dhe të kërkosh se cilët numra i ke thirrur për punë të faturimit etj.

Prandaj, ky intervenim ishte vetëm që të qartësohet dhe të kërkohet votimi i amendamenti 16 si më i përshtatshëm dhe i aprovuar prej komisionit.

KRYESUESI: Faleminderit!

Amendamentin 16

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamentin 17

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamentin 18

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamentin 19

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamentin 20

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamentin 21

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamentin 22

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

E votojmë tekstin e projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara. Votojmë tash!

Konstatohet që me 65 vota për dhe 4 abstenime, Kuvendi e miratoi Ligjin për përgjimin e komunikimeve elektronike.

9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për kompensimin e viktimave të krimit

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

E ftoj kryetaren e Komisionit Funkcional për Legjislacion, zonjën Haxhiu, që para deputetëve ta paraqesë dhe arsyetojë raportin me rekomandime. Zonja Haxhiu e keni fjalën.

Apo zoti Zemaj? Ok!

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit! Komisioni e ka shqyrtuar projektligjin, është një projektligj i ri i cili për herë të parë përdoret në sistemin juridik dhe kushtetues të vendit tonë.

Ne i kemi bërë disa ndryshime që prekin pak edhe përmbajtjen, por edhe në kompensimin që ka të bëjë me shumën e caktuar të viktimës së krimit, por që është racional edhe me deklaratën financiare të Komisionit për Buxhet dhe Financa. Komisioni kërkon që të aprovohen këto tetë amendamente. Nëse ka diçka, ne i kemi harmonizuar disa qëndrime që kanë qenë, qoftë me faktorët e jashtëm, por edhe ata që e mbështetin punën e Kuvendit, siç janë: OSBE-ja e të tjerët. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, vazhdojmë me votimin e amendamenteve.

Amendamenti 1

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 2

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 3

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 4

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 5

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 6

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 7

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 8

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

E votojmë tekstin e projektligjit në tërësi. Votojmë tash! Regjia, bjeri ziles! Albulena, të lutem votoni një herë, se për një votë nuk kalon. Votojmë tani! E përsëritim votimin.

Konstatohet se me 56 vota për, 6 kundër, Kuvendi e miratoi Ligjin për kompensimin e viktimave të krimit.

10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit Komisioni Funkcional për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim dhe miratim në parim.

Ftoj ministrin e Financave, zotin Hoti, që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe arsyetojë projektligjin.

MINISTRI ABDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesues i seancës!

Të nderuar deputetë!

Ky ligj është pjesë e pakos fiskale, të cilën e kemi dërguar në Kuvendin e Kosovës. Dy projektligje i keni aprovuar në lexim të parë, javën që shkoi.

Fokusi i kësaj pakoje fiskale është që të përmirësojë ambientin për biznes në Kosovë, të nxisë punësimin, por gjithashtu të rrisë edhe mirëqenien e qytetarëve, të përmirësojë bilancin tregtar të Kosovës dhe disa objektiva të tjera.

Propozimet në këtë pako fiskale i përfshijnë të gjitha stimulimet, që vendet tjera në regjion i kanë ofruar për biznese dhe disa çështje, në fakt ky projektligj avancohet më tutje.

Unë do shkoj shkurt nëpër disa prej çështjeve kryesore, që propozohen në këtë projektligj, i cili në fakt, për shkak të ndryshimeve të mëdha është komplet ligj i ri.

E para, është ulja e pragut të TVSH-së nga 50 mijë në 30 mijë, për të zvogëluar informalitetin, për të përfshirë më shumë biznese në kuadër të TVSH-së dhe për t'i trajtuar bizneset në mënyrë sa më të barabartë të mundshme.

E dyta, është përshkallëzimi i TVSH-së, që është ndryshim shumë i madh. Ne kemi propozuar shkallën e reduktuar të TVSH-së për produktet jetike, për bukë, kripë, vaj, vaj ushqimor, oriz, vezë, drithëra të ndryshme, qumështi, produktet e qumështit, libri shkollor, pajisjet e teknologjisë së informacionit, furnizimi me barna, produkte farmaceutike, aparate mjekësore dhe kirurgjike dhe gjithashtu edhe për disa shërbime publike, siç është furnizimi me energji, ngrohje qendrore,

mbledhje e mbeturinave, furnizim me ujë, përveç ujit të ambalazhuar, dhe pastaj shkalla standarde prej 18% e TVSH-së, për të gjitha mallrat tjera.

Me projektligj i jepet fuqi ministrit të Financave për të nxjerrë udhëzime administrative, për të mundësuar që të ndryshohet lista e mallrave që hyjnë në këtë regjim të TVSH-së, ose që ndryshohet, gjithnjë duke respektuar normën minimale të TVSH-së, në kuadër të BE-së prej 5% dhe normën maksimale prej 22%.

Ndryshim tjetër i madh është heqja e TVSH-së në importin e të gjitha linjave të prodhimit, të teknologjisë së informacionit dhe disa lëndëve të para të rëndësisë strategjike për zhvillimin e ekonomisë.

Gjithashtu, me ligj parashihet heqja e TVSH-së në rast të donacioneve edhe kur Qeveria merr pjesë deri në 20%. Ndryshimet tjera janë, çregjistrimi nga TVSH-ja që ka qenë 12 muaj, tash bëhet vetëm për 2 muaj, mandej përkufizimi i personit të tatueshëm, në përputhje me direktivat e BE-së, rregullohet qartë diskrecioni i ministrit, sa i përket implementimit dhe nxjerrjes së udhëzimeve administrative nga ky ligj, rimbursimet bëhen për çdo muaj, nëse plotësohen kushtet, nuk duhet të presin bizneset për këtë rimbursim. Dhe, gjithashtu rimbursimi mund të bëhet edhe me procedura të përshpejtuara.

Është definuar shumë mirë, se çka është borxhi i keq dhe kur mund bizneset ta llogarisin këtë borxh të keq në kuadër të shpenzimit, pa pritur për vendime të gjykatave dhe ndryshime të tjera. Janë rregulluar shumë mirë shërbimet në formë elektronike që mund t'i kryejnë bizneset dhe plotë ndryshime tjera, që e bëjnë më të lehtë implementimin e këtij ligji në praktikë.

Unë ju falënderoj për vëmendjen dhe ju ftoj ta aprovoni këtë projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kryetari i Komisionit FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa, zoti Osmani e ka fjalën.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryetar!

Projektligji për tatimin mbi vlerën e shtuar së bashku me projektligjet për tatimin në të ardhura personale dhe Projektligji në të ardhurat e korporatave janë pjesë e projektligjeve të pakos fiskale, që i paraprijnë reformës së politikës fiskale të propozuar nga Ministria e Financave, që kanë për qëllim krijimin e një ambienti më të mirë për biznesin dhe nxitjen e investimeve të reja dhe rritjen e punësimit.

Elementet kryesore të Projektligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar janë: përshkallëzimi i TVSH-së për produkte dhe shërbime të caktuara; zbritja e pragut të TVSH-së për bizneset; dhe lirime të caktuara për linjat e prodhimit.

Ajo çfarë është e rëndësishme në këtë projektligj është propozuar ulja e tatimeve të TVSH-së prej 16 në 8%, për listën esenciale të produkteve apo shportës së konsumatorëve.

Një ndryshim tjetër i rëndësishëm është heqja e TVSH-së nga të gjitha linjat e prodhimit, për të promovuar investime dhe heqja e TVSH-së nga importet e teknologjisë informative, që do të ndihmojë në zhvillimin e këtij sektori, që është në rritje në Kosovës.

Me këtë projektligj hiqet TVSH-ja në rastet e donacioneve, po ashtu edhe kur Qeveria është pjesëmarrëse 20% në këto projekte.

Ndryshime tjera janë edhe ulja e pragut të TVSH-së në 30 mijë euro të qarkullimit të bizneseve, për të cilat ne si Komision do ta shqyrtojmë me kujdes këtë ndryshim, i cili është propozuar veç në draftin, për të cilin ka edhe mendime të ndryshme.

Një çështje tjetër e rëndësishme në rregullimin në këtë projektligj, që ka të bëjë edhe me kërkesat e bizneseve, është përcaktimi i procedurave më të thjeshta dhe më efikase të rimbursimit të TVSH-së, një brengë për të cilën ka qenë deri më tash një shqetësim nga bizneset dhe kjo me këtë draft rregullohet në mënyrën më të mirë të mundshme.

Po ashtu, me këtë projektligj janë përmirësuar edhe gabimet teknike, të cilat kanë qenë goxha të theksueshme në ligjin bazik, të mëhershëm.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në mbledhjen e mbajtur më 20.5.2015, ka shqyrtuar Projektligjin për tatimin mbi vlerën e shtuar dhe ka vlerësuar se projektligji përmban kushte të domosdoshme formale-juridike të parapara me Rregulloren e Kuvendit dhe projektligji si i tillë i përmbush kushtet për miratim në lexim të parë. Prandaj, ne në emër të Komisionit, që e kemi votuar me konsensus, u bëjmë thirrje deputetëve, që ta aprovojnë në parim ligjin në fjalë, ndërsa, gjatë amendamentimit Komisioni do të bëjë përpjekjet më të mira të mundshme.

Normalisht, që do të angazhojmë edhe ekspertë nga fusha të caktuara, gjithmonë duke marrë në konsideratë edhe vërejtjet e deputetëve, që mund të vijnë lidhur me ndonjë amendamentim, t'i inkorporojmë dhe të bëjmë një ligj më të mirë të mundshëm i cili do të gjejë zbatim nga Qeveria e Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Radha është e përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, kush e ka fjalën? Zonja Demi.

LABINOTË DEMI- MURTEZI: Faleminderit, për fjalën, nënkryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi ynë parlamentar ka shqyrtuar Projektligjin për tatimin mbi vlerën e shtuar. Ne përkrahim në parim këtë projektligj dhe ftojmë të gjithë deputetët e Kuvendit që ta votojmë projektligjin dhe pastaj të kontribuojnë me amendamente deri në leximin e dytë. Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, zoti Deda e ka fjalën.

ILIR DEDA: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Zonja e zotërinj,
Unë do t'i shpalos vërejtjet e Lëvizjes “Vetëvendosje”.

Edhe pse ekonomia në Kosovë vazhdon të ketë rënie, ka rritje të varfërisë dhe papunësisë e në situatën e sotme, sipërmarrësit dhe prodhuesit e ndershëm janë buzë kolapsit, ndërsa familjet në Kosovë përballen me mbijetesë.

Tatimi në vlerë të shtuar është tatim në konsum e ne jemi ekonomi konsumuese dhe shumica e të dhënave në lidhje me konsumin në Kosovë, tregojnë se është konsum i mbijetesës, i shtresës së mesme dhe të varfër. Dhe, çdo raport vendor dhe ndërkombëtar konkludon këtë. Por, fatkeqësisht me këtë TVSH nuk adresohet problemi. Dhe, që të ulët TVSH-ja nga 16 në 8% të disa produkteve dhe të rriten të tjerat në 18%, nuk ka të bëjë me asgjë tjetër përpos të një manovre, që në fund jep hapësirë më shumë, që të mblidhen më shumë të ardhura për t'u financuar një buxhet, i cili është kryesisht i orientuar në ndërtim të rrugëve, domethënë, në asfalt dhe në pagesa veturash dhe mëdijesh.

Menaxhimi i dobët i parasë publike konstatohet çdo ditë edhe në raportet e organizatave, të cilat financohen nga buxheti publik, e të cilat bëjnë aspak punë në rritje të shërbimit të cilësisë ndaj qytetarëve apo financim të projekteve zhvillimore në sektorin publik që t'i ndihmojnë qytetarët.

Dhe, duke iu referuar gjendjes së rëndë ekonomike- shoqërore të qytetarëve tanë, kjo është një situatë më poshtë dinjitetit dhe kontributit që e meritojnë njerëzit tanë. Në alternativën qeverisëse të Lëvizjes “Vetëvendosje” ne kemi propozuar, që TVSH-ja të jetë e përshkallëzuar në Kosovë, në tri nivele. Kjo do të ishte në përputhje dhe në masë emergjente që të ndihmonte tejkalimin dhe zbutjen e katastrofës socio-ekonomike, në të cilën gjenden buxhetet familjare dhe bizneset e vogla, të mesme dhe të ndershme në Republikën e Kosovës.

Ne kemi propozuar që të hiqet plotësisht TVSH-ja në prodhimet bazë të jetës, domethënë të jetë 0%. Gjithashtu, në 0% të jenë të gjitha aktivitetet që lidhen me arsim, ndërsa si balancë kemi propozuar që produktet që konsiderohen luksoze, TVSH-ja të jetë në nivel me shtetet e BE-së, domethënë që të jetë afër 20%-shit apo përmbi 20%. Sepse, ne mendojmë se një politikë e përgjegjshme qeveritare ndaj skamjes në Kosovë, është vetëm ajo e cila në mënyrë emergjente i adreson sfidat kryesore të varfërisë të plotë në Republikën e Kosovës.

Mund të dëgjojmë sot se me këtë projektligj për TVSH po adresohen këto probleme, por, realisht duhet bërë një kalkulim. TVSH-ja e përgjithshme rritet në 18%, një qytetar mund të mendojë se kjo është rritje 2%, realisht është 13%.

Ndërsa, e kemi një listë e cila në shikim të parë duket impresive, ku kemi ulje 8%-she. Si ilustrim do t'i marr dy shembuj: për shembull, thuhet se furnizimi me energji elektrike, ngrohje qendrore, mbledhjen e hedhurinave dhe trajtimin e mbeturinave, e tjera, kemi ulje 8%. Faktikisht, është ulje 8 pikë e përqindjes dhe nuk specifikohet a është kjo ulje vetëm për amvisëri apo edhe për korporata të mëdha, sepse ekziston një dallim shumë i madh, nëse është ulje realisht 8%, që do të duhej të ishte 50% prej sot, për një pensionist dhe ndryshe është 8%-i për ndonjë korporatë të madhe.

Pastaj, thuhet se në këtë frymë edhe prodhimet prej drithërave për qëllim të konsumit njerëzor do të ulen 8 pikë të përqindjes, faktikisht. E tash, ne duhet të shohim se ku kemi mbërri. Nëse rryma nga ZRRE-ja rritet për 28%, atëherë cili 8%-ësh po ulët? Dhe, 8%-shi që ulët me këtë projektligj është në blerje me pakicë e kjo nuk mund të ngre shumë peshë e as nuk rregullon diçka të madhe, përveçse mund t'i lejojë monopolistëve, që të blejnë 8% më lirë pak prodhim që marrin nga bujqit tanë.

Po faktikisht, nëse shikojmë edhe në këtë listën: kripa, orizi, vezët, buka e tjera, dikush mund të mendojë se do të ketë përgjysmim të çmimit të bukës, realisht, ajo do të lirohet 1 cent. Dhe, shumica e produkteve lirohen 1 deri në 3 centë. Kjo nuk e zbut varfërinë e qytetarëve në Kosovë.

Dhe, kujt i leverdis pra ky lloj përshkallëzimi i TVSH-së? Dhe, nëse çmimet pas ndryshimeve ulen 1-3 centë, atëherë nuk kemi mbërri shumë, ndërsa me propozimin tonë ne do ta hiqim TVSH-në komplet në prodhimet bazë ushqimore.

Një problem e kemi te pika 3, neni 26, kapitulli i 7-të, ju jepet juve faktikisht, zoti ministër, kompetencë e madhe për zgjerimin e listës së produkteve me normë të reduktuar dhe hapësira për luajtje të TVSH-së prej 5 deri në 22. Pse duhet ta keni ju koncentrimin e madh të vendimmarrjes në luajtje të TVSH-së prej 5-22%. Kjo mund të interpretohet si e drejtë, e cila mund të kthehet në favorizim apo penalizim selektiv. Dhe, nëse ministri i Financave ka apo do të ketë “Lan Tiu”, atëherë më mirë që t'i shtohet që të hiqet kompetenca juaj dhe të rishikohet TVSH-ja me amendamentim të projektligjit, sepse një vendimmarrje e tillë e madhe nuk është paraparë deri sot dhe kolegë ministra të financave të tjerë, nuk kanë forcë aq të madhe.

E tash, ne mund ta lexojmë këtë edhe ndryshe, se kjo pikë ose na bën të dyshojmë për qëllimet dhe drejtimin në vijim me këtë TVSH, ose na vërteton çka kemi konstatuar, se ndoshta as vetë zyrtarët e Qeverisë nuk janë të sigurt në rezultatet e këtij projektligji.

Dhe është për keqardhjen më të madhe, që Qeveria me këtë TVSH, me të cilën ka pasur mundësi që ta zbusë skamjen në Kosovë, tregon se është e pavetëdijshme për gjendjen ekonomike në Republikën e Kosovës. Faktikisht ne po e shohim në kontinuitet të politikave, kjo pavetëdijesi tregon kontinuitetin e Qeverisjes Thaçi 1 dhe Thaçi 2, e cila ka qenë Qeveria përgjegjëse për degradimin më të madh ekonomik në Republikën e Kosovës. Dhe, kjo është vazhdimësi e fatkeqësisë për popullin tonë, i cili në këtë gjendje nuk mund të presë zhvillim, zbutje të varfërisë dhe qeverisje, e cila ka sens për gjendjen socio-ekonomike dhe e cila mund të përballet me këtë gjendje socio-ekonomike. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! E ka fjalën Zoti Bali Muharremaj në emër të AAK-së.

BALI MUHARREMAJ: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Ky ligj bashkë me ligjin për të ardhurat e korporatave dhe Kodin doganor përbëjnë kornizën e sistemit fiskal.

Kjo do të thotë, se ndryshimet e proklamuar në sistemin fiskal realizohen përmes ndryshimeve esenciale në këto dokumente. Projektligji i ofruar nuk përmban materie që realisht realizon

reformë fiskale të fushës. Ndryshimet e proklamuar me shumë bujë për uljen e normës së TVSH-së nga 16 në 8, kanë të bëjnë vetëm me një numër të vogël artikujsh të shportës së konsumatorit, e cila zbritje nuk e prek as 5%-shin e vlerës së mallrave të tatueshme.

Ndryshimi esencial i politikave tatimore në këtë projektligj krahasuar me ligjin në fuqi është ngritja e TVSH-së nga 16 në 18%, që i bie ngritje e normës së TVSH-së prej 12,5%. Kjo ngritje është bërë për 95% të vlerës së mallrave, që i nënshtrohet obligimit të TVSH-së.

Ky ndryshim i ligjit në fokus e ngritjen e bazës tatimore dhe rritjen e të hyrave buxhetore, vlerësohet se një e hyrë shtesë për rreth 50 milionë euro, e jo siç po mashtrohem opinionet për kinse zbritje, që kanë për qëllim uljen e çmimeve për artikujt e domosdoshëm për jetë.

Përndryshe, nëse marrim të gjithë artikujt që llogariten si artikuj të shportës dhe nëse bëjmë një bilanc nga efekti i zbritjeve dhe ngritjeve të normës së TVSH-së, del se komplet çmimi i artikujve të shportës do të ketë tri herë më shumë ngritje, se sa zbritje.

Mendojmë që artikujt e shtojcës së këtij dokumenti do të duhej të ishin përfshirë në tekst bazë të projektligjit, jo të lihen në kompetencat e ministrit, të zgjerojnë ose shkurtojnë gamën e artikujve që nënshtrohen normës së zbritjes, ashtu siç e kanë përcaktuar në projektligj, në nenin 26.

Efekti i ngritjes së normës nga 16 në 18% të TVSH-së do të bëjë që të ngritën çmimet e shumë artikujve të domosdoshëm për jetë, të artikujve dhe mallrave që shfrytëzojnë për veprimtari prodhuese, pra do të rrisin koston e prodhimit.

Kosova ka nevojë për reformë të mirëfilltë fiskale, ka nevojë për ligje të kësaj fushe, me të cilat do të jenë të qarta synimet për zhvillimin dinamik, ekonomik, treg të lirë, konkurrencë lojale dhe klimë të përshtatshme ndërmarrësie.

Prandaj, kemi rezervë dhe nuk mund t'i përkrahim këto projektligje, pa ndryshime të propozuara. Disa nga ndryshimet e propozuara, në krahasim me ligjin në fuqi, neni 5, janë hequr autoritetet qendrore dhe lokale dhe janë zëvendësuar me autonomi për eksport dhe import.

Neni 6 është propozuar ulja e pragut të TVSH-së nga 50 mijë në 30 mijë euro, por i është lënë në kompetencë ministrit, që ta ndryshojë këtë prag. Ulja e pragut është e akceptueshme, por ndryshimet e këtij pragu duhet bërë vetëm përmes ligjit në Kuvend.

Është shtuar pika e re e nenit 10, pika 3.2 lidhur me shërbimet dhe importin e mallrave. Është shtuar neni 20, pika 2.3.1 dhe 2.3.2 lidhur me shërbimet dhe janë hequr pika 2.3.4.1 dhe 2.3.4.2 lidhur me qiradhënësin.

Ndryshime ka kryesisht në nenin 20, që ka të bëjë me shërbimet. Neni 26, i cili përcakton normën e TVSH-së është ndryshuar nga neni 16 në 8% për pak artikuj, të cilët numërohen. Duhet shtuar në këtë nen edhe artikujt e shtojcës 3 dhe po ashtu, të fshihen pika 3 dhe neni 26.

Mendoj se duhet përkrahur ndryshimet e nenit 29, pika 10, 11, 12, 13 dhe 14, me të cilat lirohen nga obligimet e TVSH-së linjat e prodhimit dhe makinerisë për përdorimin në procesin e

prodhimit lëndët e para që shfrytëzohen për procesin e prodhimit, pajisjet e teknologjisë informative dhe ato për nevojat e mendimeve të shkruara dhe elektronike.

Grupi Parlamentar do t'i paraqesë disa amendamente në leximin e dytë, por këtë herë nuk do ta votojmë këtë projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! E ka fjalën zoti Hoti, në emër të Grupit Parlamentar Nisma.

ENVER HOTI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar deputetë,

Po ashtu, Grupi Nisma ka trajtuar shqyrtimin e parë të Projektligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar dhe ne konsiderojmë, i nderuar ministër, se duhet t'i merrni parasysht propozimet që do të vijnë, si për shembull, në nenin 26, paragrafi 1, propozojmë që norma standarde të mbetet në 16%.

Po ashtu paragrafi 2, norma të mbetet 5%, si dhe në paragrafin 3 21%, për arsye, se mendojmë se nëse këto merren parasysht do t'i mbrojnë konsumatorët e ultë dhe të mesëm, sepse norma 18% do të ndikonte në varfërinë e tyre, direkt apo edhe në formë indirekte.

Po ashtu, te neni 45 ku është te përmbajtja e faturës, ne mendojmë se duhet të shtohet një pikë, që përgjegjësinë për faturën me të dhëna jo të plota e mban edhe lëshuesi i faturës, sepse deri më tani, për fatura jo të rregullta janë ndëshkuar vetëm pranuesit e faturës dhe jo pronarët e faturës, gjegjësisht lëshuesit e faturës.

Nëse do të merren këto parasysht, do t'ju ndihmojnë edhe juve, i nderuar ministër.

Po ashtu, te neni 53, paragrafi 1, periudha tatimore duhet të jetë, ne propozojmë që të jetë tremujore dhe jo njëmujore, ashtu siç është propozuar në këtë projektligj.

Propozimi i katërt, neni 57 mendojmë se paragrafi 1.2. të fshihet ose të hiqet tërësisht periudha prej 20 vjeçare, sepse mendojmë se është shumë e gjatë. Ne po ashtu, brenda dy leximeve do t'i përcjellim amendamentimet tona edhe me shkrim dhe mendojmë se do të merren parasysht edhe nga Komisioni dhe nga ministri, si propozues i këtij projektligji. Faleminderit!

Tani, në parim do ta mbështesim si Grup Parlamentar që jemi.

KRYESUESI: Srpska Lista, Jasmina Živković e ka fjalën.

JASMINA ŽIVKOVIĆ: Hvala predsedavajući.

Poslanička Grupa Srpska Lista danas na ovaj nacrt zakona ne bi imala konkretnih primedbi, jer je po dnevnom redu koji je usvojen na samom početku sednice ovo drugo razmatranje nacrta zakona o porezu na dodatnu vrednost.

Želim samo da još jednom istaknem važnost da je upotreba jezika se ne svodi kao tehnička stvar nego da dovodi do velikih zabuna i velikih problema, i da se još jednom vodi računa o zvaničnim jezicima na Kosovu. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga “6+” fjalën e ka zoti Fikrim Damka.

FIKRIM DAMKA: Faleminderit, i nderuar kryetar!

“6+” Parlamento Grubu olarak bu yasa tasarısını desteklemekteyiz ve uyarılarımızı işlevsel komisyona sunacağız.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Ramiz Kelmendi.

RAMIZ KELMENDI: Faleminderit!

I nderuar kryesues,

Kabinet qeveritar,

Për të pasur përshkallëzim kualitativ të TVSH-së dhe rezultate të pritshme nga ky projektligj, së pari duhet të punohet në zvogëlimin e informalitetit dhe korrupsionit.

Duhet të implementohen plotësisht dhe kualitativisht arkat fiskale dhe të përfshihen kërkesat e biznesit kosovar në lehtësirat fiskale, që mundësojnë zhvillimin e ekonomive ekzistuese dhe bizneseve të reja e në veçanti, barazimin e këtyre bizneseve me bizneset e shteteve të regjionit.

Lirim nga TVSH-ja ishte dashur të ketë për të gjitha makineritë prodhuese, makineritë e transportit dhe makineritë për punësim individual.

Lirim nga Dogana për ambalazhimet dhe pjesët rezervë dhe repromaterialet.

Kërkesë për rimbursimin e Doganës dhe për mallra që rieksporthen dhe eksportohen për biznese që nuk kanë Zonë të lirë doganore.

Pra, ky përshkallëzim do të krijojë të hyra të reja buxhetore afër 50 milionë, domethënë, çdo qytetar i Republikës së Kosovës do të ngarkohet përafërsisht diku 30 euro për kokë të banorit.

Ndryshimi i mirë dhe pozitiv është bërë zvogëlimi i TVSH-së nga 16 në 8%, ku në këto produkte informaliteti ka qenë shumë i vogël dhe me këtë ndikohet direkt në zvogëlimin e informalitetit të mëtutjeshëm dhe ndikon, sidomos në qytetarët të cilët kanë të ardhura personale të vogla dhe janë të papunësuar, gjersa ndryshimi prej 16 në 18% do të ndikojë dukshëm në shtimin e informalitetit të këta artikuj, për arsye se edhe deri më sot, këta kanë qenë, kanë pasur ndikim shumë të madh në informalitetin në Republikën e Kosovës.

Dëmtim të dukshëm do t'i bëjnë bujqësisë, sidomos qarkullimit të produkteve bujqësore në tregjet legale. Nuk do të stimulojë zhvillimin e ekonomisë dhe prodhimtarisë, pra nëse ne presim që ky ndryshim fiskal në këtë formë do të ndikojë pozitivisht, sigurisht se nuk do të ndikojë, për arsye se të gjitha prodhimet që hyjnë në Kosovë, do të trajtohen barabarësisht me prodhimet që krijohen në Kosovë, kurse vend të veçantë, për mendimin tim, zë rritja e TVSH-së në medikamente shëndetësore. Kjo do të ndikojë shumë te pensionistët dhe njerëzit e papunë, për

arsye se mund t' ju them se një pjesë e madhe e qytetarëve të moshuar, më shumë konsumojnë barna se sa bukë.

Prandaj, për të pasur ndryshimet dhe rezultatet e pritura, deputetë të nderuar, ishte dashur që kërkesat e bizneseve që janë shumë të cekura, por që si duket janë ndoshta pak keq të kuptuara, bizneset e Republikës së Kosovës, nuk kërkojnë fare favorizim dhe përkrahje nga Qeveria jonë, por kërkojnë që politikat fiskale të jenë në funksion të barazimit të prodhimit dhe komponentëve që ata i përdorin për prodhimtaritë e tyre, në mënyrë që të jenë të barabartë në tregun e Kosovës, sidomos në tregun e Kosovës, në tregjet regjionale, e jo assesi që të kërkojnë stimulime të ndryshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! E ka fjalën zoti Muhamet Mustafa.

MUHAMET MUSTAFA: I nderuar kryesues,

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuari ministër,

Mendoj se projekti i këtij ligji rrumbullakon pakon fiskale, e cila Kosovën duhet ta bëjë më atraktive për investime dhe në këtë mënyrë të nxitet rritja ekonomike.

Domethënë, do t'i korrigjoja disa që thanë që ekonomia e Kosovës është në rënie. Ekonomia e Kosovës nuk është në rënie, ka një rritje prej vitit në vit, katër-pesë vjetët e fundit 2-3%, por, kjo rritje është e pamjaftueshme dhe të gjithë e dimë që duhet të trefishohet. E vetmja mënyrë për t'u trefishuar është që ne të kemi më tepër investime në Kosovë.

Prandaj, me këtë ligj mendoj se bëhet një kthesë e rëndësishme ngase aprovohet një kërkesë e kamotshme, ndoshta më tepër se dy-trembëdhjetë vjet, vazhdimisht ka qenë kërkesë permanente, që TVSH-ja të hiqet në investimet kapitale, domethënë në pajisjet kapitale.

Mendoj që këtu duhet të jemi shumë të qartë, të gjitha pajisjet të cilat i kontribuojnë punësimit, duhet të lirohen nga TVSH-ja. Nuk guxon të paguhet TVSH në kufi. Dhe, mendoj se ky ligj e ka realizuar këtë dhe është me shumë rëndësi që kjo të zbatohet në mënyrë efektive, sa më shpejt, sepse ka edhe investitorë që janë duke pritur këto ndryshime.

Gjithashtu, lirimi nga TVSH-ja në lëndë të para, natyrisht që është i rëndësishëm, por mendoj se duhet të jetë selektiv, sepse një lirim frontal nga pagesa e TVSH-së në lëndë të para do të pengojë prodhimin e lëndëve të para në Kosovë. Ne mund t'i lirojmë nga TVSH-ja vetëm ato lëndë të para, që s'prodhohen në Kosovë, për shembull, inputet që janë në industri të caktuar, për shembull mielli pse të lirohet nga TVSH-ja mielli që importohet, ndërsa gruri do të duhej të lirohet, sepse përpunohet në mullinj tonë.

Për këto gjëra duhet të jemi të kujdesshëm, sepse çdo gjë që e dëmton zhvillimin e prodhimit në Kosovë, duhet të jemi të kujdesshëm në këtë drejtim.

Gjithashtu, problemi ndërlihet me stabilitetin buxhetor. Ne nuk mund të bëjmë propozime për uljen e taksave, në qoftë se nuk i sigurojmë burimet plotësuese, ose nuk i zvogëlojmë shpenzimet. Natyrisht, që ka një hapësirë për zvogëlim të shpenzimeve, por jo aq të madhe,

sepse duhet të rriten investimet kapitale edhe investimet publike, natyrisht, edhe në qoftë se zvogëlohen shpenzimet, pra.

Në këtë drejtim, mendoj se është gjetur një masë e mirë zvogëlimi i TVSH-së për artikujt elementarë që kanë ndikim në situatën sociale, në të vërtetë këtu janë dhjetë artikuj, por në qoftë se e shihni ndikimin e tyre në shportën e tyre në shportën e konsumit, është shumë më i madh se sa numri i artikujve. Ndoshta, ndikimi i këtyre artikujve, për të cilët zbritet TVSH-ja diku, sigurisht 40% ose 50% të shportës së konsumit në Kosovë e ndikon pozitivisht.

Tash natyrisht, që për të ndikuar pozitivisht ne duhet të rrisim konkurrencën në treg, në mënyrë që kjo rritje e TVSH-së të shprehet edhe në uljen e çmimit të këta artikuj. Në ata artikuj që janë të rregulluar, sikurse që është energjia elektrike, kjo natyrisht se menjëherë zvogëlohet çmimi për 8%, por ata artikuj që formohet çmimi në tregun e lirë, a do të zvogëlohet për 8% çmimi i bukës e i qumështit e këtyre artikujve, varet shumë a do të jetë konkurrenca e duhur, që nuk do të lejojë që prapë të mbetet ky çmim që është. Atëherë, kjo do të shkonte vetëm në llogari të tregtarëve.

Mirëpo, nuk mendoj se ne duhet tash të zvogëlojmë, ose të mbesim në 16% për artikujt tjerë, sepse ne duhet të kemi kujdes për stabilitetin buxhetor. Prandaj, rritja e këtyre artikujve që janë të tjerë artikuj, por nuk ndikojnë shumë në shportën e konsumit prej 16 në 8%, mendoj se është e dobishme për stabilitetin buxhetor dhe unë mendoj se kjo duhet të përkrahet.

Çështja tjetër ka të bëjë për të kompletuar, ndoshta, masat e politikës ekonomike, që sigurojnë një atraktivitet më të madh për investitorë, ne duhet të ndryshojmë edhe Ligjin mbi doganat. Edhe dogana në pajisje duhet të hiqet. Unë kisha sugjeruar dhe kisha propozuar e inkurajuar ministrin, që edhe dogana në të gjitha pajisjet, në mënyrë simetrike me TVSH-në duhet të hiqet, sepse përndryshe ne do të kemi vazhdimisht edhe këtë kërkesë prej bizneseve dhe ne nuk kemi çka mbrojmë me doganë, për arsye se pajisje në Kosovë shumë pak ose hiç nuk prodhohen, e për lëndë të para është diçka tjetër.

Kisha propozuar edhe Komisionit edhe ministrit, që ta shqyrtojnë edhe njëherë diskrecionin e ministrit, për t'i ndryshuar, domethënë në mënyrë të pavarur normat me akte të tij, për arsye se mendoj që kjo do të sjellë një presion të madh te ministri, vazhdimisht do të jetë nën presion të bizneseve dhe grupeve të interesit, që të ndryshohen dhe ai domethënë do të ketë problem më tepër se sa... nga një anë ajo do t'i mundësonte një fleksibilitet më të madh për të nxitur, por nga ana tjetër do të krijojë probleme më tepër, se sa dobi. Prandaj, le të këqyrën edhe praktikën tjetra dhe deri në leximin e dytë le të shqyrtohet edhe njëherë. Faleminderit!

KRYSUESI: Faleminderit! Zoti Topalli e ka fjalën.

FATON TOPALLI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar të pranishëm,

Unë do të flas për nenin 6 të Projektligjit për TVSH-në, respektivisht uljen e pragut për TVSH-në për ndërmarrjet e vogla nga 50 mijë në 40 mijë euro.

Aktualisht, 95% e të gjitha bizneseve në Kosovë, janë biznese të vogla me më pak ... të punësuar, kryesisht në pronësi individuale apo në pronësi familjare, vetëm 5% e bizneseve në Kosovë janë të mesme apo biznese të mëdha.

Neni 6 i Projektligjit për TVSH-në nëpërmjet uljes së pragut nga 50 mijë euro prek shumicën e mikro-bizneseve në Kosovë, duke filluar nga shitoret ushqimore, libraritë, zejtarët e vegjël, tregtarët e këpucëve, shitoret e rrobave, qebaptoreset, restorantet, lulishtet, ndërmarrjet e vogla për ndërtim, ndërmarrjet e vogla të rrugëve, mishtoret, ndërmarrjet e pastrimit, byrektoret, furrat, ëmbëltoret... pra, shumë ndërmarrje të cilat bien në këtë pjesën e bizneseve prej 95%-ve.

Rritja e pragut të TVSH-së do të çojë detyrimisht në ngritjen e çmimeve duke e bërë jetën e qytetarëve të varfër të Kosovës edhe më të varfër. Me këtë hap Qeveria e Kosovës synon t'u merr bizneseve të vogla, jo vetëm pikën e fundit të dhjamt, por t'ua hajë edhe eshtrat dhe t'ua marrë edhe jetën. Ky ndryshim i pragut do të ndikojë në mbylljen e shumë bizneseve të vogla dhe do t'i lërë shumë qytetarë të papunë, duke ia shtuar ushtrisë së madhe të të papunëve dhe një numër të konsiderueshëm të qytetarëve të papunë.

Qëllimi i Qeverisë, qëllimi juaj, zoti Hoti, me nenin 6 të Ligjit për TVSH-në është t'i mbyllni bizneset e vogla, t'i mbyllni dyqanet ushqimore, pemishtet, shitoret e rrobave, shitoret e këpucëve, shitoret e sportit dhe t'ua lini në dispozicion të gjithë tregun vetëm katër- pesë ndërmarrjeve të mëdha.

Dilni në foltore, zoti Hoti, dhe tregojuni qytetarëve se ju punoni për 4-5 ndërmarrje të mëdha në Kosovë, se programi juaj ekonomik është program i shkatërrimit të ekonomisë, program i shkatërrimit të ndërmarrjeve të vogla, bizneseve të vogla, program i varfërimit, program i ngritjes së papunësisë.

Ky program është i mirë vetëm për ndërmarrje të mëdha, të cilave ju ua ulni tatimin, ndërsa shumicës së ndërmarrjeve të vogla ua rrisni tatimin. Mbjaj mend, që në mbledhjen e kaluar të këtij Kuvendi, kur ne kërkuam ngritjen e tatimit për korporatat, duke pasur parasysh mundësitë që kanë korporatat ekonomike, ju thatë, ne kemi dallime konceptuale me "Vetëvendosjen", thatë, ne jemi për uljen e tatimeve.

Atëherë, për çfarë arsye po e mashtroni opinionin publik? Pse thoni, se jeni për ulje tatimesh, ndërsa në as më shumë se një javë më vonë, sillni një ligj i cili është për ngritje të tatimeve, madje për shumicën e ndërmarrjeve të vogla.

Në fund, më lejoni të them që neni 6 i Projektligjit për TVSH-në vjen si rezultat i dështimit total të Qeverisë së re në politikat ekonomike, e cila të vetmen mundësi për të mos falimentuar e sheh duke rrjepur me tatim biznesin e vogël, çka nënkupton çmime më të larta në treg, shtim të papunësisë dhe si pasojë ulje edhe më të madhe të mirëqenies qytetare.

Këtë e vërteton më së miri buxheti i vitit 2015, i cili nga shuma totale prej rreth 1.6 miliardësh, 1.3 miliardë i siguron nga tatimi dhe doganat. Buxheti i planifikuar për vitin 2016 është jo më i lartë, por 4 milionë më i ulët se buxheti i këtij viti. Këto shifra të prezantuara nga vetë Qeveria

tregojnë krizën e thellë në të cilën ndodhemi dhe, shpjegon pak a shumë, pse Qeveria që në teori është për uljen e tatimeve, në praktikë i ngrit ato.

Planifikimi për vitin 2016 i buxhetit, pra 4 milionë më i ulët se në vitin 2015, tregon se Qeveria po e sheh të ardhmen e saj bukur të zymtë. Kjo zymtësi e parashikuar dhe e llogaritur nga vetë Qeveria tregon, se viti i ardhshëm do të jetë për shumicën e qytetarëve të Kosovës edhe më i vështirë, se sa ky vit.

Lëvizja “Vetëvendosje” me programin e saj qeverisës, me politika që stimulojnë bizneset e vogla dhe të mesme, nëpërmjet masave të shpejta si skema garantuese, fonde investive dhe subvencionim të kamatave, por në asnjë mënyrë duke ngritur pragun për TVSH, sidomos kur ngritja e parashikuar godet vetëm bizneset e vogla. Pra, ktheni pragun ashtu siç ka qenë në 50 mijë euro, mos e mbushni buxhetin e Kosovës me paratë e fukarave, merrni ku ka dhe jepni ku nuk ka, sepse qytetari i Kosovës është lodhur me këto politika ekonomike të cilat nuk kanë fare parasysh gjendjen e qytetarëve të Kosovës dhe një shpërndarje pak a shumë më të drejtë të të hyrave të vendit tonë.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Kadriu e ka fjalën.

MARGARITA KADRIU-UKELLI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

I nderuar ministër,

Sot e kemi në shqyrtim të parë ndryshimin e Projektligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar të sjell nga Ministria e Financave dhe kur ky ndryshim-ligj u paraqit dhe kaloi në Qeveri, u krijua përshtypja se qytetarët së shpejti do të paguajnë më lirë për produktet ushqimore bazë si produkte të shportës.

Me këtë ndryshim të Projektligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar parashihet reduktimi i TVSH-së nga 16% sa është aktualisht në 8% për disa produkte bazike të shportës, mirëpo, të gjitha të tjerat do të rriten prej 16 sa është aktualisht në 18%, përjashtoj këto që janë me zero, gjë që i bie se konsumatorët për të gjitha produktet e tjera do të paguajnë hiq më pak se 12.5% më shumë.

Zbritja e TVSH-së mund të reflektohet drejtpërdrejt në faturën e ujit, ngrohjes dhe energjisë për konsumatorët, mirëpo e njëjta nuk do të ndodhë për ushqimet elementare. Do të jemi dëshmitarë se në shumë raste do të përfitojnë tregtarët e papërgjegjshëm dhe prodhuesit.

Thjeshtë kjo zbritje ka shumë gjasa se nuk do të reflektojë ose të them më but, fare pak në vlerën e shportës së konsumatorit. Këto ndryshime do t'i ngarkohen shumicës së popullatës pasi për një numër të konsiderueshëm të produkteve TVSH-ja do të rritet nga 16 në 18%, pra po e përsëris, diku 12.5% më shumë.

Në këtë krizë, kushtimisht ta quaj ekonomike, konsideroj se kjo rritje prej 12.5% është rritje e madhe dhe shumë vështirë e përballueshme. Konsideroj se është e panevojshme rritja aq e madhe e TVSH-së ose që më së paku të rritet prej 16 në 17% për të gjitha produktet tjera, por kurrësi jo në 18%, sepse në këtë krizë në vend, qytetarët do ta kenë më vështirë ta përballojnë një rritje të tillë duke i shtuar çmimit edhe 12.5%.

Kjo mënyrë që e ka zgjedhur Qeveria është pa dyshim mënyra më e lehtë për Qeverinë për t'i rritur të hyrat në buxhetin e Kosovës, mirëpo, a është mënyra më e drejtë? Jo. Padyshim se nuk është e drejtë e as reale.

Konsideroj se atë që Qeveria do të duhej ta bënte është që të fillojë dhe të lodhet pak më shumë duke luftuar informalitetin dhe kontrabandën për të mbushur buxhetin e shtetit sikur edhe të angazhohet seriozisht në rritjen e shtrirjes së tatimeve në rritje horizontale e gjithëpërfshirëse, duke i përfshirë edhe ata që në vazhdimësi po abuzojnë me ligjet.

Para po thuaj se 6 muajsh unë propozova në këtë Kuvend, në këtë foltore që të formojmë një komision ad hoc të posaçëm hetues parlamentar, i përbërë nga të gjitha përfaqësimet në Parlament, i cili do të hetonte dhe do të bënte gjetjet e qëndrueshme dhe të besueshme për të vërtetën reale në mbledhjen e taksave dhe tatimeve.

Me këtë veprim ne do t'i siguronim buxhetit, respektivisht qytetarit të këtij vendi edhe më shumë se 1 miliard euro për buxhetin e shtetit, mirëpo kalkulimet politike të disa grupeve parlamentare bëjnë që kjo nismë ende e pafilluar të mbetet për momentin e përealizuar. Shpresoj të realizohet.

Ministria e Financave duhet urgjentisht të themi kështu shprehimisht t'i përvjelë mangët dhe të mos lejojë që çdo vit kalendarik të humbim nga një buxhet të tërë dhe atë duke i adresuar gjurmët e shpërdorimeve të cilido zyrtar të lartë, të mesëm apo të ulët në të gjitha pushtetet.

Vetëm në këtë mënyrë mund të realizojmë vullnetin e qytetarëve duke e mbushur buxhetin për plotësimin e të gjitha nevojave të vendit.

Realisht, mbi 15 vjet qytetarët janë udhëhequr nga politikanë të cilët kryesisht nuk kanë marrë asnjë vendim me peshë për zhvillim ekonomik serioz dhe të dobishëm për qytetarët e vendit, përjashto Klubin e oligarkëve. Bile edhe atëherë, kur është marrë ndonjë vendim, me përmbajtje ekonomike, qëllimi ka qenë thjeshtë politik, ad-hoc dhe për interesa të ndonjë lideri, partie apo grupi të caktuar, por jo në interes të qytetarëve.

Të nderuar,

Po shkon gjysma e vitit të Qeverisë së re, ndërsa ekonomia, si zakonisht për momentin ende nuk po shihet se po bëhet prioritet me këto politika zyrtare. Ky ligj, me korrigjime të cilat duhet t'i bëjmë dhe unë insistoј që mos të bëhet 18 po 17%, domethënë ndryshimi, në këtë mënyrë mund të arrijmë dalëngadalë t'ia kthejmë shpresën dhe besimin qytetarëve, sepse shpresa dhe besimi i tyre fatkeqësisht po vazhdon të bjerë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Fetahu e ka fjalën.

NAIM FETAHU: I nderuar kryesues i Parlamentit,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Më lejoni që në fillim të përshëndes dhe në veçanti sponzorizuesit e këtij ligji për TVSH, ministrin e Financave, me të cilin projektligj ne po dëshmojmë se jemi drejt integritit në shtëpinë e madhe të BE-së e po ashtu jemi të gatshëm që çdo direktivë të BE-së e cila është e favorshme për vendin ta marrim dhe implementojmë.

Projektligji për TVSH është projektligj, siç e kemi të njohur, për tatimin mbi konsumin të cilin e pagan apo obligohet ta paguajë konsumatori i fundit.

Në bazë të këtij projektligji, përveç shumë çështjeve që u është dhënë trajtim i duhur, si ulja e normave pastaj lejimi i linjave të prodhimit dhe makinerisë pa TVSH dhe i lëndës së parë, tregon përkushtimin e Qeverisë se është për t'u mundësuar grupeve të interesit të biznesit dhe çdo investitori një klimë të favorshme për të bërë biznes.

Te ky projektligj unë kam disa çështje apo disa pika që mendoj se duhet sqaruar, hequr ose riformuluar. E them këtë, sepse kam vërejtur që mund të kenë ndikim negativ te konsumatori.

E para, tek përkufizimet, në projektligj neni 2 nën paragrafi 1, paragrafi 5 të pjesës së dytë të këtij paragrafi, citoj: “si mallra kapitale duhet të konsiderohen edhe ato shërbime të cilat i kanë karakteristikat e ngjashme me ato të cilat i atribuojnë mallrave kapitale, në qoftë se kjo kosto e tyre totale e shërbimeve i tejkalon 20 mijë euro”.

Shtrohet pyetja se çfarë është menduar lidhur me këtë rast, se cilat janë ato shërbime, sa janë inovative, sa kanë efekt pozitiv në këtë fushë, sa janë efektet negative të saj, zbritja dhe e drejta për të zbritur, e tjera. Pra, ndoshta duhet të riformulohet ose opinioni im është që të hiqet ky tekst i këtij nën paragrafi që e citova më lart.

Nen 2 - të neni 2, nën paragrafi 1, pika 29 - grupimi i personave me qëllime të TVSH-së, mendoj se duhet pasur kujdes të pjesës së këtij paragrafi kur thuhet: duhet përjashtuar të gjitha ortakëritë, kur dihet se tek përkufizimet për çështje të TVSH, me person kuptohet edhe ortakëria dhe llojet e saj, si dhe a është në kundërshtim me paragrafin 4, neni 6 të këtij projektligji.

Te paragrafi 2, i nenit 16 të projektligjit, unë mendoj se ky paragraf duhet të hiqet, pasi ka qenë i hequr edhe me ligjin paraprak - Ligjit numër 4/108 për TVSH nga qershori i vitit 2012, ku ky paragraf nuk ka gjetur mundësi të implementohet në Kosovë dhe është në kundërshtim edhe me vetveten dhe konceptin e tatimit të saj.

Te neni 26, paragrafi 2, pika 13, mendoj se ky është në kundërshtim me atë që thashë më herët se Kosova duhet të përafrohet edhe më shumë me biznesin dhe t'u mundësohet lehtësira, mirëpo ky nen është në kurrizin e konsumatorëve.

Nuk mund të pajtohem se barërat dhe të gjitha pajisjet medicinale, shërbimet medicinale, aparatura mjekësore dhe shërbimet e mirëmbajtjes së këtyre aparaturave, që 14 vjet nga implementimi i TVSH-së në Kosovë, kanë qenë të përjashtuar e sot këto produkte esenciale për shëndetin e njeriut, qytetarit të kenë apo të paguajnë TVSH me një normë 8%.

Po ashtu ky nen dhe paragraf është në kundërshtim të plotë me nenin 27 të po këtij ligji. Nuk po ashtu një ndarje, se cilat janë ato barna me këtë normë apo se si duhet të ndahen saktësisht këto barna, a duhet të përfshihet vetëm lista esenciale apo edhe sëmundjet tjera të cilat duhet të definohen.

Në fund, unë propozoj që ky ligj të hyjë në fuqi jo më 1 korrik, por më 1 janar të vitit 2016, sepse mendoj që duhet punuar dhe njoftuar më mirë komunitetin e biznesit - qytetarët dhe për këtë çështje duhet bërë përgatitje më të mëdha Administrata Tatimore dhe Doganat.

Këto të fundit, siç thashë, janë dëshmitarë të gjitha problemeve, sepse implementimet e ligjeve në gjysmë të vitit gjithmonë kanë paraqitur problem, andaj propozoj që ky ligj të hyjë në fuqi më 1 janar 2016, sepse në këtë formë do të mund ta informojmë opinionin më mirë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kurti e ka fjalën.

ALBIN KURTI: Deputetë të Kuvendit të Kosovës,
Qeveria e ka bërë një ndryshim të vogël te Projektligji për TVSH-në, në mënyrë që ta maskojë faktin se realisht nuk ka ndryshime te Projektligjet mbi tatimet në të ardhurat personale dhe ato mbi të ardhurat e korporatave.

Ulja e TVSH-së për disa mallra bazike të konsumit nga 16% në 8% dhe ngritja e saj prej 16% në 18% për shumë mallra që nuk janë të luksit, vetëm sa do ta rrisë buxhetin që mbledhet nga TVSh-ja. Edhe më tutje, mjetet e grumbulluara nga TVSH-ja do të jenë mbi dyfishin e atyre nga tatimi mbi korporatat.

Ky mos ndryshim në aspektin ekonomik është dëshmi që LDK-ja i është bashkuar PDK-së në qeverisjen e njëjtë.

Çfarë është kjo qeverisje e njëjtë? Tri gjëra i ka bërë ish- kryeministri Thaçi në ekonominë e Kosovës. Së pari, e zvogëloi tatimin në fitim e të ardhura prej 20% në 10% dhe krahasuar me vitin kur PDK ishte opozitë, pra 2007, e gjer më sot edhe investimet e huaja direkte janë përgjysmuar, pra zvogëlimi i tatimit nuk i rriti investimet e huaja.

Së dyti, e zgjeroi privatizimin e ndërmarrjeve shoqërore edhe me ato publike, jo nga përllogaritja ekonomike, por nga verbëria ideologjike.

Dhe, së treti, buxhetin e shpenzoi në asfalt autostradash, ku çmimi ishte sa trefishi i atij të tregut e me kontrata që nuk u bënë publike asnjëherë.

Si pasojë e këtyre tri gjërave, kemi tri gjëra të tjera. Së pari, deficitin tregtar u dyfishua përderisa Thaçi ishte kryeministër, së dyti, u rrit edhe korrupsioni, u dyfishua për nga shkalla sipas organizatave ndërkombëtare dhe, së treti, u rrit shumë edhe numri i azilkërkuesve nga Kosova për vendet e Bashkimit Evropian.

Tatimi në të ardhurat e korporatave nga 1 janari i vitit 2009, pat rënë prej 20% në 10%. Kjo shënonte fundin e besimit në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe fillimin e thirrjes dëshpëruese për investime të huaja të korporatave. Mirëpo, krejt çka fituam është “Bechtel&Enka” dhe “Limak&Çalik”. Në fakt, ne humbëm shumë e ishin ata që fituan e po fitojnë shumë.

Asnjëra prej këtyre që u trashëguan nga Qeveria e mëhershme nuk u kontestuan, nuk u hetuan e nuk u shqyrtuan nga kjo Qeveri, e cila po vazhdon me mbindërtim në bazën e njëjtë. Tash, me orientimin e njëjtë, nuk mund të presim rezultate të tjera, por veçse edhe më shumë gjëra të njëjta. Edhe kjo Qeveri e Kosovës nuk ndodhet te regjistri i zhvillimit ekonomik, por tek ai i kontabilitetit financiar. T’ia marrësh 1,4 miliardë euro buxhetit të shtetit e t’ia bartësh korporatës “Bechtel-Enka” dhe ta shënosh te rritja e bruto-produktit vendor si shpenzim kapital, nuk paraqet zhvillim por kontabilitet.

Deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Liria dhe të drejtat kanë bazë materiale. Ato s’mund të realizohen për të gjithë pa rishpërndarje, prandaj, të drejtat dhe liritë në raport me shtetin kanë nevojë për vetë shtetin që të vlejnjë dhe realizohen për të gjithë e jo vetëm për disa. Demokracia duhet të jetë nga poshtë-lart, kurse shpërndarja e të ardhurave nga lart-poshtë. Me Qeverinë që e ka kapur maksimalisht shtetin dhe me tatimin minimal të sheshtë, në Kosovë e kemi saktësisht të kundërtën. Pra, e kemi demokracinë prej lart poshtë dhe e kemi shpërndarjen prej poshtë lart. E demokracia, prej lart është autokraci, kurse shpërndarja prej poshtë është koncentrik.

Deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Shoqërinë e mban shteti, kurse shtetin e mbajnë tatimet. Nuk ka shtet social pa tatim progresiv, as konceptualisht dhe as materialisht. Tatimi progresiv gjithsesi është zgjidhje shumë më e mirë dhe më e drejtë sesa shkurtime të shpenzimeve publike, aq më tepër në një vend si Kosova, ku sistemi i shfrytëzimit dyfish të varfrit dhe klasën e mesme e të cilët përbëjnë shumicën dërrmuese të popullsisë: individualisht i shfrytëzon me kamata të larta të kredive dhe kolektivisht me tatim jo progresiv çfarë avokoni ju.

Në Projektligjin për tatimet, shija që lë kjo Qeveri është se tatimi është disi i keq, por ja që s’kemi se çka bëjmë. Mirëpo, kjo është pikëpamje e atyre që kanë shumë, e atyre që janë pakicë tek ne. Projektligjet mbi tatimet të kësaj Qeverie janë projektligje të pakicës për pakicën, sepse shumica në Kosovë nuk janë të pasur.

Qeveria aktuale edhe me memorandum shpjegues të këtij projektligji, shpesh thotë që do ta luftojë evazionin fiskal tek sa dihet që numri i bizneseve në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës, është dyfish më i lartë sesa i atyre në Administratën Tatimore të Kosovës e që nuk mund ta shpjegohet vetëm me bizneset e falimentuara e jo të çregjistruara. Mirëpo, evazion fiskal në Kosovë më së shumti bëjnë biznesmenët e lidhur me pushtetin dhe të tjerët pastaj duke u orvatur të jenë konkurrues me ta. Maunat e miqve biznesmenë të qeveritarëve në kufi s’paguajnë doganë, e biznesmenët e tjerë mandej s’paguajnë tatim.

Ulja e pragut të TVSH-së nga 50 000 euro në 30 000 euro, nuk i ndihmon bizneset e vogla dhe as ato të reja që kur lindin natyrisht se janë të vogla. Me këso politike fiskale ky pushtet vetëm sa i fut duart në magjen e të varfërve, kurse i përkëdhel të pasurit. Biznesin e vogël që është edhe familjar edhe i mbijetesës e ngulfat.

Ministër Hoti,

Natyrisht se ju mendoni që 30 milionë euro janë më shumë se 30 euro. 30 milionë euro, njëmend matematikisht janë më shumë se 30 euro, por, padyshim që shumëfish më tepër i dhemb një

biznesi të vogël kur ia merr 30 euro taksë a tatim a gjobë sesa kur një korporate shumëmiliardëshe ia merr 30 milionë euro.

Pra, pikënisja e juaj nuk është as jeta shoqërore, as tërësia, por është njëfarë lloj aritmetike vulgare e pabarazisë, ku ju konsideroni që thjesht 30 milionë euro janë më shumë se 30 euro, por më mirë është t’ia marrim 30 milionë “Behtel&Enkas” sesa pafund bizneseve të vogla e të mesme 30 euro. Sepse ato 30 euro një biznesi të vogël i dhembën shumë më tepër se sa 30 milionë euro një korporate shumëmiliardëshe si “Behtel&Enka”, “Limak&Çalik” apo të ngjashme.

Edhe lirimi nga tatimi i biznesit në rast të riinvestimit të dividendës, që e propagandoni shumë, nuk do t’i rrisë investimet ashtu qysh beson kjo Qeveri. Fituesi i Çmimit Nobel për Ekonomi, para një dekade, Joseph E. Stiglitz, me të drejtë thotë që - po citoj: “Ajo çka po i ndal investimet si në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ashtu edhe në Evropë është mungesa e kërkesës, e jo tatimet e larta”. Në fakt, duke ditur se shumica e investimeve financohen me borxh, dhe se pagesat e interesit kanë taksa më të ulëta, ndikimi i tatimit në korporata ka ndikim të vogël në investime. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Gaxherri e ka fjalën.

BESA GAXHERRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Kolegë deputetë,

Ne, sot po e shqyrtojmë Ligjin për tatimin në vlerën e shtuar, një ndër ligjet e pakos fiskale të Qeverisë Mustafa dhe është më të vërtet kënaqësi që e shohim një sinjal që vërtet kjo Qeveri e ka marrë shumë seriozisht ndryshimin e politikave fiskale në Kosovë, që është e domosdoshme.

Me pakon fiskale e një ndër ligjet që po e diskutojmë sot, kjo Qeveri dhe në veçanti Ministria e Financave, po ndryshon qasjen ndaj ekonomisë dhe bizneseve aktuale si dhe hapjen e mundësive të investitorëve për investime të huaja dhe vendore në vend.

Me pakon e re fiskale do të krijohen edhe mundësitë e luftimit të informalitetit. Konsideroj se ky nuk është ligj i fundit i cili e përmbyll pakon fiskale, jam shumë e sigurt që ne do të punojmë në vazhdimësi për të ndryshuar ligjet e caktuara që vërtet Kosova të bëhet një vend që tërheq investimet dhe që çdo investitor e ndien veten të sigurt në Kosovë.

Natyrisht me pakon fiskale, Republika e Kosovës ofron kushte të favorshme dhe të krahueshme me regjionin. Ne e dimë çfarë duhet ndryshuar, por edhe çdo ekonomist e di se duhet për çdo ndryshim në politikat fiskale të vendit duhet edhe t’i ruajë balancat ekonomike.

Natyrisht, askush nuk mund të thotë se me këtë ligj nuk ka asnjë lloj ndryshimi, kur vërtet në bazë të këtij ligji ne shohim se stimulohen bizneset, kur bëhet ulja e pragut të TVSH-së i bizneseve nga 50 mijë në 30 mijë, përshkallëzimi i TVSH-së për produktet ushqimore esenciale, farmaceutike, ulje e TVSH në ujëra, energjetikë, mbeturina e kështu me radhë, heqja e TVSH-së për sektorin e prodhimit, heqja e TVSH të teknologjisë informative, heqja e TVSH-së për donacione që Qeveria merr pjesë 20% në to e kështu me radhë, dhe përmes këtij ligji është rimbursimi me procedura të përshpejtuar.

Natyrisht se ky ligj është në leximin e parë dhe ne kemi mundësi që për këtë ligj të kontribuojmë të gjithë përmes Komisionit kryesor sikur që është ai për Buxhet, por asnjë deputeti nuk i mbyllet mundësia që të kontribuojë dhe këtë ligj ta begatojmë dhe ta bëjmë më të mirin të mundshëm.

Ne, vërtet do të punojmë dhe për sa ta përmbyllim këtë ligj, bashkë me ministrin e Financave, do të punojmë dhe shikojmë edhe për ligjet tjera, që vërtet Kosovës ia krijojmë një klimë krejt tjetërfare për zhvillimin ekonomik të këtij vendi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesues!

Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Në ndryshimet që janë sjell sot në Ligjin për tatimin e vlerës së shtuar, kur i kemi parasysh edhe dy ligjet e javës së kaluar, që i miratuar këtu në Kuvend në lexim të parë, pra Ligjin për tatimin e të ardhurave personale dhe atë për korporatat, por edhe vendimet tjera të politikave fiskale që i ka sjell kjo Qeveri, është vështirë që të vërehet një lidhje e qartë mes tyre, që do të na mundësonte të kuptojmë më lehtë se cili është vizioni i Qeverisë për rolin e politikave fiskale në arritjen e objektivave kryesore të saj dhe si mendon kjo Qeveri që t'i përdorë këto politika për kryesisht rrjedhat ekonomike në vend.

Mallrat për të cilat do të reduktohet norma e tatimit në vlerë të shtuar, sipas këtij ligji, janë shumë më të pakta se sa numri i mallrave tek të cilat do të aplikohet rritja e normës standarde prej 16 sa është aktualisht në 18%. Ministri ka deklaruar më herët se kjo rritje nuk do të reflektohet në rritje të çmimeve meqë, sipas tij, është rritje e vogël dhe se mallrat të cilat do të ngarkohen me këtë normë karakterizohen me kërkesë elastike.

Pra, të dyja këto konstatime, sipas mendimit tim, janë të pasakta. E para, rritja e normës prej 16 në 18% është një rritje për 12.5%, siç u tha këtu më herët, e obligimit tatimor, ndërkohë që kjo nuk mund të llogaritet si rritje e vogël, në anën tjetër, është e palogjikshme të thuhet se afër 90% të mallrave të konsumit kanë kërkesë elastike.

Sipas një raporti që e ka bërë Instituti GAP, ku e vlerëson reflektimin buxhetor që do të kenë këto ndryshime në tatimin në vlerë të shtuar, aty thuhet se pak a shumë, duke i marrë për bazë të dhënat e Doganave për vitin 2014, që efekti neto negativ, pra nga ulja e tatimit në vlerë të shtuar prej 16 në 8%, në buxhetin e Republikës së Kosovës, do të jetë diku 5 milionë euro, ndërkohë që efekti pozitiv për shkak të rritjes nga 16 në 18%, do të jetë mbi 50 milionë euro. Këtu shihet qartë, domethënë që do të ketë një ndikim në shportën e konsumatorit, të cilat sipas Institutit GAP gjithnjë, do të shtrenjtohet përgjithësisht për 1% me këto ndryshime tatimore, pra konsumatorët do të paguajnë më shtrenjtë për shportën e tyre se sa që paguajnë aktualisht.

Më herët me dy ligjet tjera që u miratuan nga ky Kuvend, shkallët tatimore për të ardhurat personale dhe ato për korporatat nuk u prekën fare. Shkalla e sipërme e tatimit në të ardhura ka mbetur në 10%, ndërkohë që tatimi i sheshtë për korporata po ashtu mbetet në 10%.

E vetmja normë tatimore që po ngrihet është tatimi në vlerë të shtuar apo siç quhet ndryshe tatimi në konsum. Dhe atë edhe për një pjesë të konsiderueshme të mallrave të konsumit bazë,

konsum ky masiv nga i cili nuk mund të ikë asnjë qytetar, pavarësisht shumës së të ardhurave mujore familjare që ata i kanë.

Shtoja kësaj edhe faktin se ulja e pragut të TVSH-së në 30 mijë euro, do t'i rëndojë edhe më bizneset e vogla, duke ua vështirësuar atyre edhe më konkurrencën me ato të mëdha. Përderisa ndryshimet tatimore në vitin 2009 e bartën barrën e financimit të buxhetit të shtresat e mesme dhe ato të ulëta, këto ndryshimet e vitit 2015 po ia ngrenë peshën kësaj barre. Kështu të varfrit po bëhen edhe më të varfër, ndërkohë që ata pak të pasur, edhe pse formalisht po duket që nuk do të preken, realisht po privilegjojnë.

Këto masa po e koncentrojnë pasurinë dhe po e rrisin hendekun mes të kamurve dhe të skamurve. Si rezultat, ky bie ndesh drejtpërsëdrejti me parimin bazë të Republikës, i cili është barazia dhe të drejtat shoqërore brenda saj, dhe në këtë mënyrë po dëmtohet edhe ekonomia duke reduktuar fuqinë agregate blerëse dhe kështu duke e reduktuar konsumin.

Në afat të gjatë, kjo e tkurrë ekonominë duke e futur atë në krizë. Reduktimi i kërkesës kursen reduktim të ofertës. Reduktimi i ofertës nënkupton humbja e vendeve të punës, për shkak se kur ka nevojë të prodhojë më pak, nuk ka nevojë për më shumë punëtorë, dhe rrjedhimisht këtu futemi në një vorbull të pafund të krizave që e ushqejnë njëra-tjetrën.

Ulja e pragut të TVSH-së në 30 000 është e ngutshme dhe e kalkuluar gabimisht. E ngutshme, meqenëse Administrata Tatimore e Kosovës ende nuk ka kapacitet të mjaftueshëm për administrim të TVSH-së në bazë të gjerë. Kjo rritje e numrit të bizneseve nuk mund të menaxhohet me numrin e tashëm të inspektorëve tatimorë, dhe me nivelin aktual profesional. Dhe është kalkuluar gabimisht meqenëse me siguri se numri i bizneseve që do të përfshihen në skemë është shumë më i lartë se sa ai i parashikuar prej 1 800 sosh nga sponsorizuesit e ligjit.

Në fakt, shumë thjesht mund të dokumentohet se asnjë biznes që ka të paktën një të punësuar, nuk mund të mbijetojë nëse nuk arrin qarkullim vjetor prej minimalisht 30 000 eurove. Ulja e pragut të TVSH-së, bashkë me përshkallëzimin e normave të aplikuara, insentivat për grumbullimin e kuponëve fiskal dhe tendenca për fiskalizim të sa më shumë subjekteve do të jenë tepër shumë sfida me të cilat do të përballlet përnjëherë Administrata Tatimore e vendit kërkohet të ballafaqohet njëkohësisht.

Politikat fiskale natyrisht se nuk janë të ndara, ato e kanë pjesën e të hyrave, mbledhjen e tatimeve që po e diskutojmë këtu, por edhe atë të shpenzimeve. Deri tash e kemi parë Qeverinë të merret me pjesën e të hyrave.

Dhe, me këto propozime të Qeverisë ajo po na tregon se do të vazhdojë me politika substancialisht të njëjta me ato të ndjekura deri tash. Dhe e njëjta po ndodh edhe me shpenzimet, më saktësisht me cilësinë e shpenzimeve të parasë publike. Buxhetin aktual e kemi të njëjtë me atë të viteve të kaluara.

Dhe, këtu nuk po flas për detaje, por për shpenzimet kryesore, infrastrukture, por edhe te sektorët prioritarë të financuar. Për të ardhur te pika të cilën po e diskutojmë, TVSH po ngrihet me shpresë se do të rezultojë në të hyra më të shumta për buxhetin tashmë të stërzgjeruar

financiarisht. Me TVSH të rritur, pra me konsum masiv më të shtrenjtë, po i financojmë kontratat super të shtrenjta të qeverisë me Bechtelin, evazionin fiskal të bizneseve të mëdha, luksin e korrupsionin qeveritar. Përgjithësisht ata që po paguajnë më së shumti për buxhetin po fitojnë dhe po përfitojnë njëkohësisht më së paku shërbime dhe të mira publike nga ky buxhet.

Edhe një gjë, në shumë raste ligji për TVSH është i paprecizuar dhe kërkon rregullim të mëtejshëm përmes akteve nënligjore. Është fakt që shumica e ligjeve tatimore kanë nevojë për precizime shtesë përmes akteve nënligjore, por brenda një ligji, plot 32 herë të thuhet se kjo fushë do të rregullohet me akt nënligjor nga ministri, tregon se praktikisht ligji nuk definon asgjë dhe gjithçka mbetet pastaj në duart e ministrit. Kjo i jep një peshë të madhe politike një ministri për një çështje kaq të rëndësishme siç janë tatimet. Në këtë mënyrë Kuvendi anashkalohet, dhe përqendrimi i pushtetit në duart e ekzekutivit shkon drejtpërdrejt ndesh me idenë e demokracisë dhe me idenë e Republikës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Fatmir Rexhepi e ka fjalën.

FATMIR REXHEPI: Faleminderit, kryesues i seancës!

Përsëritet kolegjë deputetë,

Përsëritet ministër,

Lidhur Projektligjit për ndryshimin e tatimit në lirim, mbi tatimin e vlerës së shtuar, unë do t'i them pak fjalë.

Realisht ajo që kam pritur për qëllimin e mirë të asaj që e ka thënë ministri se do të përpiqemi të bëjmë një paketë e cila do të ofrojë ose stimulojë më shumë, qoftë në prodhimin vendor, të sektorit tonë prodhues apo edhe disa lehtësime që kanë të bëjnë me kategoritë lidhur me pajisjet apo diçka tjetër, tani veç me këtë debat dhe me formën që është ardhur, unë do t'i jap dy- tri vërejtje.

E para, çdonjëri prej neve pajtohet në parim që të ketë ndryshime dhe plotësime të cilat shkojnë në favor të asaj që e ndihmojnë ekonominë, zhvillimin, sektorin prodhues e tjera.

Por, duke e shikuar këtë çfarë është ofruar, personalisht për veti kam dilemën e madhe dhe nuk e ndaj atë mendim se ngritja e TVSH-së prej 16% në 18% do të jetë në funksion të këtyre politikave që kemi biseduar më herët. Është një ndryshim shumë i madh për të cilin mendoj duhet një analizë edhe shumë më përmbajtësore nga ana e Ministrisë përkatëse që të shohë se çfarë impakti realisht ka ngritja dhe çfarë arsyeshmërie tjetër ekonomike ka që të rrisim ne koston e çdo prodhimi në Kosovë, duke marrë parasysh konkurrencën e cila drejtpërdrejt që do të ndikojë në koston e atij prodhimi, në çmimet që dalin në treg e tjera e tjera.

Pra, unë mendoj se kjo dukshëm do të dëmtojë dhe do të ketë ndikim në sektorin prodhues. Çdo çmim pra i prodhimeve të gjitha fabrikave ose të cilësdo industri që është sot në Kosovë, ngritja nga 16 në 18% do të ketë një impakt të jashtëzakonshëm të cilin sigurisht se nuk do ta mirëpresin. Dhe këtu, menjëherë biem ndesh mes atyre projekteve dhe planeve të mëhershme se do të kemi lehtësira, do të kemi politika të cilat e stimulojnë sektorin prodhues dhe krejt çka është ofruar. Pra, kjo është ajo dilema që realisht në parim nuk e përkrah. Pra, nuk kam pritur

diçka krejt tjetër, por në këtë formë dhe në këtë mënyrë nuk mund ta përkrah dhe të pajtohem se duhet të rritet TVSH prej 16 në 18%.

Dhe, tash, të mos i jap vetes të drejtë, unë kam dëshirë që të ulët Ministria dhe të shohë cili është bilanci real në pikëpamje financiare në mes atyre që e kanë zvogëluar për produktet që e kanë zvogëluar dhe kësaj pjesës tjetër, sikur që u tha edhe nga deputetë tjerë, e cila është më me interes edhe për sektorin prodhues, për zhvillimin, për investimin apo për një grup të caktuar të shoqërisë. Pra, unë po kërkoj që kjo të shikohet edhe një herë, të rishqyrtohet dhe pastaj deri në leximin e dytë, realisht, të bëhen ato ndryshime, por edhe një herë po them parimisht nuk jam absolutisht të ngritët absolutisht prej 16 në 18% dhe nuk mund ta përkrah, sepse do të ketë impakt të madh dhe do t'i bëjë dëm prodhimit dhe sektorit prodhues në Kosovë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Salihu e ka fjalën.

SALIH SALIHU: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë,

Unë do të diskutoj pak rreth TVSH-së për imputet bujqësore, konkretisht për pesticidet në kuadër të së cilave hyjnë insekticidet, fungicidet, herbicidet dhe rotendicidet. Këtu në ligj nuk janë fare të precizuara këto impute bujqësore mjaft të rëndësishme, përveç se në fund të ligjit kemi një shtojcë numër 4, me produkte bujqësore ku kanë përshkrimin dhe kodin e këtyre produkteve, mirëpo në bazë të kësaj liste, por edhe në bazë të informacionit që kemi nga terreni, insekticidet, do të thotë, janë të ngarkuara me TVSH 16%.

Pra, ne mendojmë që edhe insekticidet duhet të lirohen nga TVSH për shkak se shërbejnë gjithashtu sikur edhe preparatet tjera kimike për mbrojtjen e bimëve dhe për shkak se e kanë një çmim bukur të lartë, prandaj nuk mendoj se duhet të kenë TVSH insekticidet.

Kjo do të ndikonte sigurisht në uljen e kostos së prodhimit të produkteve bujqësore dhe natyrisht me përdorimin e pesticideve, sigurisht se edhe produktet do të jenë më cilësore.

Tash nuk e di me cilin udhëzim administrativ është, e për këtë ndoshta ministri zoti Hoti do të na e shpjegojë, por konsideroj që sikur këto preparatet tjera kimike, do të thotë, edhe insekticidet në këtë rast duhet të lirohen nga TVSH-ja se kjo e ndihmon bukur shumë prodhimin e bujqësisë dhe e ulë koston e prodhimit në bujqësi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! I fundit është zoti Sadriu.

ALI SADRIU: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Përshëndetje ministër,

Kolegë deputetë,

U tha shumëçka dhe unë nuk dua të përsëris, por do të ndalem vetëm në dy-tri pika, për çka vërejta se ka konfuzitet tek njerëzit si e kanë kuptuar.

E para, ulja e pragut të TVSH-së është një hap pozitiv edhe për bizneset e vogla, dhe shumë hap pozitiv. Një preferim i tillë ka qenë qysh nga viti 2004 dhe atëherë janë marrë veprime që të ndodhë kjo ulje e pragut të TVSH nga 50 për qind në 30%. Janë pranuar njerëz, janë trajnuar

njerëz dhe më vonë nuk ka vepruar. Unë e vërej një ngurtësi të politikave që janë udhëhequr në vitet e kaluara në raport me politikat fiskale.

Politikat fiskale duhet të jenë diçka dinamike, të efektohet, të veprohet në kohë dhe automatikisht do t'i lidh këtë edhe me kompetencat që ministri do të ndërmarrë veprime të kësaj natyre dhe unë mendoj që janë të mirëseardhura dhe janë praktika që përdoren në vendet e zhvilluara. Por, këtu mund të shtoj se mund të kërkojmë dhe duhet të kërkojmë që ministri të raportojë në Kuvend për cilat biznese i ka marrë ato veprime, sepse Administrata Tatimore duhet të frymojë me bizneset dhe duhet të veprojë atëherë kur vëren se një biznes në periudha të caktuara ka krizë. Dhe, unë prapë po e lidhi, se këto duhet të raportohen, sepse është një kompetencë mjaft e gjerë që është në funksion të një interesi të përgjithshëm, por nëse nuk raportohet kjo mund të lexohet edhe jo drejt.

Te përshkallëzimi i TVSH-së, unë vërej se është ndërmarrë një hap drejt, pikërisht për shtresat e varfra dhe prodhimin vendor. Një prej impulseve më të mira në këtë rast, që energjinë elektrike e ulë si TVSH dhe ajo inkorporohet në çdo çmim, por në veçanti në biznese të vogla. Flas për TVSH-në deri në 30 mijë. Unë po vërej që disa e kanë kuptuar se deri tash s'ka pasur tatim. Ka pasur tatim por e ka pasur tatimin e paragjykuar dhe bizneset e vogla janë ankuar se është vepruar sipas dëshirës së inspektorit, tani veprohet sipas rregullave që i përcakton Administrata Tatimore dhe ligji.

Pra, është një hap shumë pozitiv dhe ta kuptojmë në këtë drejtim. Nuk rritet. Aty, jam thel i bindur, mund edhe t'u zvogëlohet bizneseve të cokatura, por të zvogëlohet me rregulla e jo në mënyrë paushall.

U thanë disa gjëra dhe unë dua t'i përsëris në kuptimin e asaj që duhet të reflektojmë gjatë amendamentimit. Kolegu i fundit i përmendi herbicidet. Janë diçka që e shtojnë prodhimin dhe efektet e tyre buxhetore, zoti ministër, janë të vogla. Prandaj, duhet të kemi parasysh atë, sepse ndikon pozitivisht. Apo edhe rastin, kur profesor Muhameti e përmendi grurin dhe miellin. Kosova e ka industrinë e miellit shumë të zhvilluar dhe ka kapacitete jo vetëm për furnizim me miell në Kosovë, por edhe për eksport, prandaj është e natyrshme që TVSH-ja të jetë një miell, por të ulet në grurë, që kështu do ta stimulojmë edhe prodhimin vendor, por edhe do t'i hapim mundësi industrisë së mullinjve të përfitojnë në kuptimin përmes eksportit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër, nëse e doni fjalën, urdhëroni!

MINISTRI ABDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesues i seancës!

Ju përshëndes edhe një herë.

Unë i dëgjova me vëmendje të gjitha diskutimet dhe kam marrë shënime, dhe besoj gjatë dy leximeve mund t'i implementojmë dhe mund të shohim se si mund t'i përmirësojmë disa prej neneve, të paqartësuar, që mund të jenë eventualisht në këtë projektligj.

Pra, më lejoni të qartësoj edhe një herë, ky ligj i prek tri elemente, i arrin tri objektiva, ose në fakt kontribuon në arritjen e këtyre objektivave, është aspekti social. Ne po e ulim TVSH-në prej 16 në 8%. Tani unë e kuptoj që prej disa prej mallrave që i rregullon tregu dhe shpresojmë se konkurrenca ashtu sikur që tha edhe profesor Muhameti, e ulë çmimin, e përgjysmon ngarkesën

tatimore për konsumatorë, por së paku në gjysmën e atyre mallrave çmimet janë të rregulluara, furnizimi me ujë, me energji e tjera e tjera, që nuk janë vetëm për konsumatorë por është imput i rëndësishëm edhe për energjinë.

E dyta, është zhvillimi ekonomik. Ne po bëjmë ndryshimin më të madh, fundamental që 15 vjet, heqjen e TVSH-së prej të gjitha makinerive prodhuese, heqjen e TVSH-së prej të gjitha lëndëve të para që i quajmë strategjike, pra lëndë të parë që nuk prodhohen në Kosovë dhe do të jemi të kujdesshëm me studime adekuate të vendosim se cilat prej lëndëve të para do të lirohen nga TVSH, heqjen e TVSH-së nga importi i pajisjeve të teknologjisë informative, një sektor që po zhvillohet sidomos tek rinia.

Dhe e treta, është qëndrueshmëria fiskale. Pavarësisht prej konsideratave që unë i kam për standardin e jetës, e tjera e tjera, ne duhet të kujdesemi edhe për qëndrueshmërinë fiskale, prandaj jemi munduar që duke e ulur TVSH-në nga 16 në 8% të prekim shportën e konsumatorit të 50-60% të familjeve që pjesën më të madhe të shpenzimeve mujore që i bëjnë ata i bëjnë për këto mallra elementare, në të njëjtën kohë të kujdesemi që të mos e prekim qëndrueshmërinë fiskale të vendit, një qëndrueshmëri fiskale që është ndërtuar me vite, të cilën ne nuk guxojmë ta rrezikojmë tani.

Pajtohem që të rishikojmë diskrecionin e ministrit sa i përket udhëzimeve administrative, nuk e kam këtu asnjë problem këtu që të ulemi e diskutojmë me grupe parlamentare në këtë drejtim. Atë që ne e kemi përfshirë në projektligj është diskrecioni i ministrit plotësisht në përputhje me praktikat e vendeve të Bashkimit Evropian. Mund t'i shohim ato një nga një dhe të shohim se ku mund ta heqim këtë diskrecion, ta bëjmë pjesë të ligjit, ose atë që e propozoi, deputeti Ali Sadriu, që çfarëdo ndryshimi që bën ministri të raportohet në Komisionin për Buxhet ose të raportohet në Kuvend.

Besoj që gjatë qershorit, po edhe nëse s'mbërrin në qershor, eventualisht në korrik, ne do të vijmë me propozimin tjetër për lirimet doganore që e përcjellin ligjin e TVSH-së, për makineri prodhuese, për lëndë të para dhe për tjera.

Do të mundohemi t'i qartësojmë disa prej neneve që i përmendi zoti Naim Fetahu. Do të punojmë bashkë me të dhe me Grupin Parlamentar të PDK-së në këtë drejtim.

Tek pesticidet, insekticidet, këto sipas informatave që unë i kam, janë të rregulluara në përputhje me Direktivën 6 të BE-së, por për shkak të ndikimit shumë të vogël në buxhetin e shtetit mund të ulemi dhe të shohim se si mund t'i rregullojmë më mirë. Pra, unë do të punoj me të gjithë juve dhe me grupet parlamentare që gjatë dy leximeve t'i implementojmë shumicën e vërejtjeve dhe komenteve që i dhatë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit zoti ministër! Në sallë kemi 67 deputetë. Do ta votojmë Projektligjin në parim për tatimin mbi vlerën e shtuar. Ju lus të përgatitemi për votim. Votojmë tani!

Faleminderit! Konstatoj se me 44 vota për, 19 kundër dhe 2 abstenime, Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për tatimin mbi vlerën e shtuar.

Kërkohej nga Komisioni Funktional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren të Kuvendit ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

Me kështu e mbyllet seancën e sotme. Mirupafshim në seancën e radhës, që mbahet nesër, në orën 10:00.

E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë